

## Në emër të popullit

Gjykata Themelore e Mitrovicës në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarët e EULEX-it: Dariusz Sielicki në cilësi të kryetarit të trupit gjykues, Vidar Stensland dhe Anna Adamska Gallant në cilësi të anëtarëve të trupit gjykues ndihmuar nga zyrtari ligjor i EULEX-it Agron Kelmendi në cilësi të procesmbajtësit në lëndën penale P.58/2014 kundër të akuzuarve në vijim që akuzohen me aktakuzën Nr. PPS.no. 88/11 të ngritur nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës më 8 nëntor 2013 kundër:

1. **A. D.**, emri i babës S.D.2., lindur më \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_;
2. **B. D.**, emri i babës S.D.2, lindur më \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_;
3. **D. D.**, emri i babës S.D.2., lindur më \_\_\_\_\_;
4. **S. D.**, emri i babës S.D.2., lindur më \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_;
5. **F. D.**, emri i babës H.D., lindur më \_\_\_\_\_;
6. **J. D.**, emri i babës H.D., lindur më \_\_\_\_\_;
7. **N. D.**, emri i babës H.D., lindur më \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_;
8. **Z. D.**, emri i babës H.D., lindur më \_\_\_\_\_;
9. **S. S.**, emri i babës Sh.S, lindur më \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_;
10. **I. Th.**, emri i babës A.Th., lindur më \_\_\_\_\_;

pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur publikisht dhe në prani të të gjithë të akuzuarve dhe avokatëve të tyre mbrojtës, përkatësisht:

Imer Ahmetaj për **A. D.**; Shefqet Ibrahimimi për **B. D.**;  
Kadri Osaj për **D. D.**; Ruzhdi Maloku për **S. D.1**;  
Vehbi Beqiri për **F. D.**; Mexhid Syla për **J. D.**;  
Bashkim Mehana për **N. D.**; Bajram Tmava për **Z. D.**;  
Gregor Guy Smith, Tome Gashi, dhe Ibrahim Dobruna për **S. S.**; Artan Qerkini për **I. Th.**;

në datat: 27 qershor, 9 dhe 10 korrik, 11 dhe 12 gusht, 15 dhe 16 shtator, 10 tetor, 17 dhe 24 nëntor 2014, 9, 10 dhe 15 dhjetor 2015; 13 janar, 11 dhe 12 shkurt, 20 mars, 2 dhe 23 prill, 11, 15 dhe 25 maj 2015;

pas këshillimit dhe votimit të trupit gjykues të mbajtur më 25 dhe 26 maj 2015, më 27 maj 2015, sipas nenit 359 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPK), në prani të të akuzuarve, avokatëve të tyre mbrojtës, dhe Prokurorit të EULEX-it nga Prokuroria Speciale e Kosovës Charles Harđaëay, shpall publikisht këtë:

#### **AKTGJYKIM**

**I. A. D., B. D., D. D., S. D. 1., F. D., J. D., N. D., Z. D., S. S., dhe I. Th.,** janë fajtor për veprimin kriminal në vijim: se, gjatë konfliktit të brendshëm të armatosur në \_\_\_\_\_, në një datë të pacaktuar \_\_\_\_\_, duke vepruar në cilësi të pjesëtarëve të \_\_\_\_\_, në bashkëkryerje me njëri tjetrin dhe me pjesëtarë të \_\_\_\_\_ deri më tani të paidentifikuar, kanë shkelur rëndë nenin 3 të përbashkët për katër Konventat e

Gjenevës të datës 12 gusht 1949 sepse me dashje kanë kryer dhunë, trajtim mizor, torturë dhe trajtim poshtërues dhe degradues ndaj Dëshmitarit A dhe Dëshmitarit B, dy civilë \_\_\_\_\_ të paraburgosur në objektin e paraburgimit në \_\_\_\_\_ (Komuna e \_\_\_\_\_), të cilët nuk kishin marrë pjesë aktive në veprime ushtarake, duke i rrahur me grushte dhe shkopinj druri, duke i urdhëruar Dëshmitarin A dhe Dëshmitarin B ta rrahin njëri tjetrin, dhe duke ia shtrënguar organet gjenitale Dëshmitarit A me një mjet hekuri, dhe sipas nenit 33, para. 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ky veprim klasifikohet:

si krim lufte nga neni 31 dhe 152 para. 1 dhe para. 2 nënpara. 2.1 dhe 2.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), që ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013 dhe në shkelje të nenit 4 para. 2 (a) i Protokollit Shtesë II (PSH II) të Konventave në fjalë, dhe për këtë vepër penale:

sipas nenit 31 dhe 152 para. 1 të KPRK dhe nenit 45 para.1 KPRK modifikuar me nenin 33 para.2 i Kushtetutës dhe nenit 38 para.1 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ( LPRSFJ) në germën e tij që ka hyrë në fuqi më 1 korrik 1977 që ka mbetur në fuqi me para. 1.3 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 të datës 12 dhjetor 1999, **J. D.**, **Z. D.**, **S. S.**, dhe **I. Th.**, dënohen:

- **S. S.** - me 7 (shtatë) vjet burgim;
- **J. D.** me 6 (gjashtë) vjet burgim;
- **Z. D.** me 6 (gjashtë) vjet burgim;
- **I. Th.** me 6 (gjashtë) vjet burgim;

dhe sipas nenit 31 dhe 152 para. 1 dhe nenit 45 para. 1 të KPRK modifikuar me nenin 33 para.2 të Kushtetutës dhe nenin 38 para 1 dhe 2 të LPRSFJ në germën e tij që ka hyrë në fuqi më 1 korrik 1977 që ka mbetur në fuqi me para. 1.3 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 të datës 12 dhjetor 1999 dhe nenin 75 para.

1, nënpara. 1.2 dhe nenin 76 para. 1, nënpara. 1.2 të KPRK: **A. D., B. D., D. D., S.D.1., F. D.,** dhe **N. D.** dënohen:

- **A. D.** 3 (tre) vjet burgim
- **D. D.** 3 (tre) vjet burgim
- **B. D.** 3 (tre) vjet burgim
- **S. D.** 3 (tre) vjet burgim
- **F. D.** 3 (tre) vjet burgim
- **N. D.** 3 (tre) vjet burgim

**II. J. D., Z. D., S. S.,** dhe **I. Th.,** janë fajtor për veprimin kriminal në vijim:

se, gjatë konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, në disa raste në gusht dhe \_\_\_\_\_, duke vepruar në cilësi të pjesëtarëve të \_\_\_\_\_, në bashkëkryerje me njëri tjetrin dhe me pjesëtarë të \_\_\_\_\_ deri më tani të paidentifikuar, kanë shkelur rëndë nenin 3 të përbashkët për katër Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949, sepse me dashje kanë kryer dhunë, trajtim mizor, torturë, dhe trajtim poshtërues dhe degradues ndaj Dëshmitarit A, civil \_\_\_\_\_ i paraburgosur në objektin e paraburgimit të \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_ ( \_\_\_\_\_), i cili nuk kishte marrë pjesë aktive në veprimet ushtarake, duke e rrahur me shkopinj druri dhe me grushte në pjesë të ndryshme të trupit, brenda në qelinë e paraburgimit, dhe ky veprim,

sipas nenit 33 para. 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës klasifikohet si krim lufte në vazhdim nga neni 81 para.1, neni 31, neni 152 para. 1 dhe para. 2, nënpara. 2.1 dhe 2.2 i KPRK, dhe në shkelje të nenit 4 Para. 2 (a) PSH II, dhe për këtë veprë penale,

sipas nenit 31 dhe nenit 152 para. 1 dhe nenit 45 para.1 KPRK modifikuar me nenin 33 para. 2 të Kushtetutës dhe nenit 38 para.1 të LPRSFJ në germën e tij që ka hyrë në fuqi më 1 korrik 1977 dhe ka mbetur në fuqi me para. 1.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 të datës 12 dhjetor 1999, ata dënohen:

- **S. S.** me 6 (gjashtë) vjet burgim;
- **J. D.**- me 5 (pesë) vjet burgim;
- **Z. D.** me 5 (pesë) vjet burgim;
- **I.Th.** me 5 (pesë) vjet burgim;

**III.** Sipas nenit 80 para. (1) dhe para. (2) nënpara. 2.1 të KPRK, për të gjitha veprat që u atribuohen, **J. D.**, **Z. D.**, **S. S.**, dhe **I. Th.** dhe pasi janë marrë në konsideratë dënimet individuale të shqiptuara për ato vepra, ata dënohen me dënime unike:

- **S. S.** me 8 (tetë) vjet burgim;
- **J. D.** me 7 (shtatë) vjet burgim;
- **Z. D.** me 7 (shtatë) vjet burgim;
- **I. Th.** me 7 (shtatë) vjet burgim;

**IV.** Sipas nenit 83 para 1) KPRK, periudha e privimit nga liria e **Z. D.**, dhe **J. D.** nga data 23 maj 2013 dhe **I. Th.** nga data 24 maj, përkatësisht deri më 31 maj 2013, në arrest shtëpiak, dhe nga data 31 maj 2013 deri 19 dhjetor 2014 në paraburgim, do të llogaritet në mënyrë përkatëse në dënimin unik me burg të shqiptuar ndaj secilit;

**V.** Sipas nenit 453 Para. 3 i KPPRK, shpenzimet e procedurës penale do të kompensohen pjesërisht nga:

- **J. D** në shumën e planifikuar prej 1000 Euro;
- **Z. D.,** në shumën e planifikuar prej 500 Euro;
- **S. S.** në shumën e planifikuar prej 500 Euro;
- **I. Th.** në shumën e planifikuar prej 500 Euro;
- **A. D.** në shumën e planifikuar prej 300 Euro;
- **B. D.** në shumën e planifikuar prej 300 Euro;
- **D. D.,** në shumën e planifikuar prej 300 Euro
- **S. D.,** në shumën e planifikuar prej 300 Euro;
- **F. D.,** në shumën e planifikuar prej 300 Euro;
- **N. D.,** në shumën e planifikuar prej 300 Euro;

ndërsa shpenzimet e mbetura të procedurës penale do të paguhen nga burimet buxhetore.

## **ARSYETIM**

### **A. Historia procedurale dhe veprimet**

#### **I. Aktakuza**

1. Më 8 nëntor 2013 Prokurori i EULEX-it ka paraqitur një aktakuzë nr. PPS 88/11 të datës 6 nëntor 2013 kundër  
**S. G., S.J., J.D., S.S.,**  
**I.H., S.L., A.Z., I.Th.,**  
**Z.D., A.D., B.D., D.D.,**  
**S. D. 1., F. D., N. D..**

2. **A. D., S. S., I. Th., Z. D., F. D., N. D., S. D. 1., D. D., B. D., dhe J. D.** janë akuzuar me akuzat në vijim (akuzat 1(1), 2(1), 3(1), 4(1), 5(1), 6(2), 7(1), 8(2), 13 (4), dhe 14 (2) në aktakuzë ):

Se në cilësinë e tyre si pjesëtarë të \_\_\_\_\_ (\_\_\_\_), në bashkëkryerje me njëri tjetrin dhe me pjesëtarë tjerë të \_\_\_\_\_ deri më tani të paidentifikuar, kanë shkelur integritetin trupor dhe shëndetin e Dëshmitarit A dhe Dëshmitarit B, dy civil të mbajtur në qendrën e paraburgimit në \_\_\_\_\_, duke i :

- **rrahje me grushte dhe me shkopinj të drurit;**
- duke e detyruar Dëshmitarin A dhe Dëshmitarin B me rrah njëri tjetrin.
- Pickimi i gjenitaleve të Dëshmitarit A me një mjet të hekurit dhe më pas e kanë tërheqë zvarrë nëpër dysheme ,

në \_\_\_\_\_ ( \_\_\_\_\_ ), në një datë të pacaktuar në shtator 1998.

3. **J.D., S.S., I.Th.,** and **Z. D.** gjithashtu ishin të akuzuar për pikat në vijim (pikat 6(1), 8(1), 13(3), dhe 14(1) të aktakuzës ):

Se në cilësinë e tyre si pjesëtarë të \_\_\_\_\_ (\_\_\_\_), në bashkëkryerje me njëri tjetrin dhe me pjesëtarë tjerë të \_\_\_\_\_ deri më tani të paidentifikuar, në një numër të rasteve ata e kanë shkelur integritetin trupor dhe shëndetësor të Dëshmitarit A, një civil i paraburgosur në qendrën e paraburgimit në \_\_\_\_\_, duke e rrahur me grushte dhe shkopinj të drurit në pjesë të ndryshme të trupit të tij në \_\_\_\_\_ ( \_\_\_\_\_ ), në disa data të pacaktuara në \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_.

4. Të dyja këto akuza janë klasifikuar në aktakuzë si krime lufte kundër popullatës civile në nenet 22 dhe 142 të Ligjin Penal të RSFJ-së, aktualisht e penalizur me nenet 31 dhe 152 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), në shkelje të nenit të përbashkët 3 deri 4 të Konventës së Gjenevës së 12 gushtit 1949 dhe të nenit 4 të protokollit shtesë II të Konventës së lartpërmendur.
5. Në aktakuzën e njëjtë , **S. G., S. J., J. D., S. S., I. H.,** dhe **A. Z.** janë akuzuar për krime të ndryshme lufte kundër popullatës civile të cilat dyshohet të kenë ndodhur në \_\_\_\_\_ gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë. **S. L.** dhe **I. H.** janë akuzuar për krime lufte të cilat dyshohet se kanë ndodhur gjatë konfliktit por në tjera lokacione. Të gjithë të akuzuarit janë akuzuar për shkelje të integritetit trupor dhe shëndetësor të civilëve. Akuzat kundër **S. L., S, G, dhe S, J,** kanë përfshirë edhe vrasje. Këto akuza janë veçuar me aktvendim të kryetarit të trupit gjykues të datës 14 prill 2014 në mënyrë që të dëgjohen në një procedurë tjetër.

## **II. Kundërshtimet e aktakuzës**

6. Me aktvendimin e kryetarit të trupit gjykues të datës 8 shkurt 2014 kundërshtimet për pranueshmërinë e provave të paraqitur në aktakuzë, ngritur nga të gjithë avokatët mbrojtës së bashku me kërkesën për të hedhur poshtë aktakuzën janë refuzuar si të pabaza. Ky aktvendim është mbështetur nga Gjykata e Apelit më 8 prill 2014.

## **III. Kompetencat e gjykatës dhe përbërja e trupit gjykues**



7. Në bazë të nenit 11 paragrafi 1 të Ligjit mbi Gjykata, ligji nr. 03/L-199, juridiksioni për gjykuar të gjitha veprat penale në instancë të parë që i takojnë Gjykatës Themelore.
  
8. Aktakuza ka paraqitur se veprat penale të cilat i përbëjnë akuzat të cilat janë kryer në rajonin e \_\_\_\_\_, që është në territorin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë. Për këtë arsye, në bazë të nenit 29 paragrafi 1 i KPPK, kjo gjykatë ka juridiksion territorial për ta gjykuar këtë lëndë.
  
9. Rasti është hetuar nga Zyra e Prokurorisë Speciale të Kosovës, prandaj në bazë të nenit 3.1 të Ligjit 03/L-053 Ligji mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe të prokurorive të EULEX-it në Kosovë, Gjyqtarët e EULEX-it kanë kompetenca dhe juridiksion ndaj këtij rasti.
  
10. Në bazë të nenit 286 të KPPK, shqyrtimi gjyqësor mbahet në selinë e gjykatës dhe në ndërtesën e gjykatës.
  
11. Më 26 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës Themelore në Mitrovicë ka refuzuar propozimin për ndryshimin e vendit, të paraqitur nga avokati mbrojtës Gregor Guy Smith më 23 qershor 2014.
  
12. Është një fakt i pamohueshëm se që nga muaji mars 2008 deri në ditën kur është nxjerrë aktgjykimi për shkak të kërkesave specifike të sigurisë në veri të Mitrovicës, është përcaktuar një praktikë ku lëndët penale në Gjykatën Themelore të Mitrovicës, gjykohen nga trupi gjykues i përbërë ekskluzivisht nga gjyqtarë të EULEX-it. Kjo praktikë nuk është kontestuar asnjëherë nga gjykatat e çfarëdo instance. Neni 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive

themelore si dhe neni 31 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës e siguron të drejtën për qasje në gjykatë jo vetëm për të pandehurit por edhe për palët e dëmtuara. Termi "tribunali i themeluar me ligj" i cili përdoret në dispozitën e përmendur i referohet edhe legjislacionit vendor mbi juridiksionin territorial dhe faktik. Duket se pjesëmarrja ekskluzive e gjyqtarëve të EULEX-it ishte e vetmja mënyrë për të vëzhguar të drejtën për qasje në gjykatë.

13. Kjo praktikë është ri-afirmuar në marrëveshjen në mes të Shefit të EULEX-it në Kosovë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi aspektet relevante të aktivitetit dhe bashkëpunimit të gjyqtarëve të EULEX-it me gjyqtarët e Kosovës të cilët punojnë në gjykata vendore ("Marrëveshja") e 18 qershorit 2014, ku nën nenin 5 (a), marrëveshja thekson se:

*"Gjyqtarët e EULEX-it do të sigurohen që Gjykata Themelore e Mitrovicës të mbetet funksionale, derisa sistemi multietnik gjyqësor në veri të zbatohet dhe të jetë funksional".*

14. Asnjë çështje nuk është ngritë nga palët sa i përket përbërjes së trupit gjykues. Prandaj supozohet se në bazë të nenit 382 paragrafi 4 i KPPRK ata kanë heqë dorë nga e drejta për të parashtruar ankesë për përbërjen.

#### **IV. Shqyrtimi gjyqësor**

##### **a. Kohëzgjatja e shqyrtimit gjyqësor**

15. Shqyrtimi gjyqësor ka filluar më 27 qershor 2014 dhe ka përfunduar me 25 maj 2015. Gjykimi është mbajtur për 23 ditë.

16. Për shkak të kohëzgjatjes së rëndësishme të dëshmimeve të dëshmitarëve për prokurorinë, kohëzgjatja e shqyrtimit gjyqësor ka tejkaluar periudhën kalendarike prej 120 ditësh, siç parashihet në nenin 314 paragrafi 1.2 i KPPRK. Megjithatë, të gjitha shtyrjet më pas të urdhëruara nga trupi gjykues nuk i kanë tejkaluar 30 ditë dhe gjithmonë janë arsyetuar me indikacionin se veprimet procedurale do të ndërmerren në seancën e ardhshme gjyqësore.

17. Palët nuk i kanë ngritë kundërshtimet e tyre në lidhje me kohëzgjatjen e shqyrtimit gjyqësor. Prandaj, në bazë të nenit 382 paragrafi 4 i KPPRK është supozuar se ata kanë heqë dorë nga e drejta për tu ankuar për këtë çështje.

#### **b. Ambientet e gjykatës**

18. Për shkak të numrit të madh të pjesëmarrësve dhe pjesëtarëve në publik të cilët ishin të interesuar për të vëzhguar procedurën, janë bërë aranzhime të veçanta në mënyrë që të zhvillohet gjykimi në mënyrën e duhur. Salla e gjykimit ishte e mobiluar me mobile të cilat përdoren zakonisht në Kosovë dhe kishte kondicioner. Madhësia e sallës së gjykimit ka lejuar hapësirë të mjaftueshme për palët, për përafërsisht 80 ulëse të rezervuara për publik dhe gjithashtu për sallë për kamerat e TV-së. Anëtarët e secilit ekip mbrojtës, që do të thotë të pandehurit, avokatët e tyre mbrojtës dhe personat të cilët i ndihmojnë avokatët ishin ulur së bashku; secili ekip i mbrojtjes është ulur në një bankë të veçantë në mënyrë që të lejohet komunikimi në konfidencial me ekipin.

**c. Masat e ndërmarra për të siguruar qasjen e publikut në sallën e gjykimit**

19. Qasja e publikut është ndihmuar duke i shpallur datat e gjykimit në fund të çdo seance të gjykimit dhe përveç kësaj edhe në faqen e internetit të EULEX-it. Policia e Kosovës ka ndihmuar pjesëtarët e publikut për të arritur në sallën e gjykimit. Nuk ka pasur incidente të sigurisë të raportuara sa i përket lëvizjeve të pjesëtarëve të publikut në veri të Mitrovicës. Para trupit gjykues nuk është paraqitur asnjë ankesë mbi kufizimin apo pengimin për qasje në sallën e gjykimit.

**d. Siguria në sallën e gjykimit**

20. Ka pasur masa të sigurisë të zakonshme për raste të profilit të lartë në Kosovë të cilat zbatohen gjatë tërë gjykimit. Këto kanë përfshirë mos lejimin e sjelljes së objekteve të mëdha në sallën e gjykimit, dhe kontrollet personale me detektor të metalit në hyrje në sallën e gjykimit. Zyrtaret e Policisë të Kosovës ishin prezent të sallën e gjykimit. Nuk ka pasur incidente të sigurisë të raportuara në sallën e gjykimit.

**e. Prania e palëve**

21. Gjatë tërë kohëzgjatjes së gjykimit të pranishëm ishin prokurorët e EULEX-it të Prokurorisë Speciale të Kosovës, të akuzuarit dhe avokatët e tyre mbrojtës.

22. Palët e dëmtuara Dëshmitari A dhe Dëshmitari B janë informuar në mënyrë të duhur për gjykimin dhe për të drejtat e tyre procedurale dhe se shqyrtimi gjyqësor mund të mbahet në mungesë të tyre. Ata të dytë janë paraqitë

në sallën e gjykimit vetëm në cilësi të dëshmitarëve dhe nuk e kanë ushtruar të drejtën e tyre të palëve gjatë gjykimit.

#### **f. Gjuha e procedurës, përkthimi dhe procesbajtja**

23. Sipas nenit 16 të Ligjit mbi Juridiksionin dhe Kompetencat e Gjyqtarëve të EULEX-it dhe Prokurorëve në Kosovë, gjuha e përdorur në procedurat gjyqësore është gjuha angleze.

24. Në pajtim me nenin 1 paragrafin 2 të KPPK, përkthyesit kanë përkthyer gjatë procedurës gjyqësore dhe të gjitha dokumentet relevante për gjykim nga gjuha angleze në gj. shqipe dhe anasjelltas. Shumica e përkthimeve janë bërë në mënyrë konsektive. Kryetari i trupit gjykues ka kërkuar nga folësit që të flasin në intervale gjatë shprehjes së tyre, zakonisht 1 deri në 3 minuta dhe si parim në fund të çdo mendimi të kompletuar dhe pastaj përkthyesi e ka përkthyer atë që është shprehur në gjuhën e caktuar. Kjo metodë i ka lejuar palët që të kontrollojnë saktësinë e përkthimeve të të gjitha provave të cilat janë paraqitur në sallën e gjykimit.

25. Në disa raste palët i kanë ngritë kundërshtimet e tyre sa i përket kualitetit të përkthimit. Të gjitha kundërshtimet janë shqyrtuar menjëherë dhe sqarimi është futur në procesverbal.

26. Fjala përmbyllëse e palëve dhe shpallja e dispozitivit të aktgjykimit janë përkthyer në mënyrë simultane në gjuhën angleze, gjuhën shqipe dhe gjuhën serbe.

27. Në bazë të vendimit të kryetari të trupit gjykues, më 27 qershor 2014, në bazë të nenit 315 paragrafëve 2 dhe 5 të KPPK-së procesverbali i procedurës është bërë tekstualisht me shkrim dhe pa audio incizim, video apo

stenografik. Është shpjeguar se koha për përkthim do t'i mundësonte procesmbajtësve që të kapin në mënyrë të saktë dhe të shkruajnë të gjitha fjalët të cilat janë shprehur në sallën e gjyqimit. Me këtë vendim, trupi gjykues e ka refuzuar kërkesën e paraqitur më 19 qershor 2014 me shkrim nga avokati mbrojtës Guy-Smith, i cili ka kërkuar audio dhe video incizim të procedurës.

28. Saktësia e procesverbalit është kontrolluar nga kryetari i trupit gjykues me kohë. Monitori i kompjuterit është vendosur para tij. Kjo mënyrë e mbajtjes së procesverbalit na ka bërë që përdorimi i metodave tjera të procesmbajtës të ishte e panevojshme pasi që ishte e pamundur që të arrihet ndonjë saktësi më e madhe e përmbajtjes semantike e procesverbalit.

#### **g. Masat e mbrojtjes**

29. Më 11 gusht 2014 në bazë të nenit 222 paragrafi 1 dhe nenit 339 paragrafit 3 të KPPK, trupi gjykues ka urdhëruar masat e mbrojtjes në lidhje me dëshmitarët e propozuar nga prokuroria. Është vendosur që:

29.1. Dëshmitarëve në vijim, Dëshmitarit A, Dëshmitarit B, dhe gruas së Dëshmitarit A, vëllait të Dëshmitarit A dhe gruas së Dëshmitarit B do të iu jepet anonimitet i plotë nga publiku dhe gruas së Dëshmitarit A dhe gruas së Dëshmitarit B do t'iu jepen pseudonimet në vijim: përkatësisht K, L, dhe M.

29.2. Emrat, adresat, vendet e punës apo çfarëdo e dhënë tjetër e cila do të mund të përdorej për të identifikuar këta dëshmitarë duhet të fshihen nga të gjitha dokumentet e lidhura me këtë rast.

29.3. Çfarëdo e dhënë e cila i identifikon këta dëshmitarë nuk do të zbulohet.

29.4. Palët dhe cilido person tjetër që posedon informata mbi identitetin e këtyre dëshmitarëve janë urdhëruar që të mos i zbulojnë këto të dhëna apo prova materiale të cilat mund të qojnë drejt zbulimit të identitetit të tyre. Kjo përfshin edhe kopjet e redaktuara të raporteve të policisë dhe deklaratat e redaktuara të dëshmitarëve.

29.5. Dëshmitarët e lartpërmendur do të dëgjoreshin përmes video lidhjes nga një vend në largësi; megjithatë nuk do të ketë shtrembërim të fytyrës.

29.6. Media dhe publiku do të mbeteshin në gjykatë por pa mundësinë për të parë fytyrat e dëshmitarëve dhe mediat dhe publiku do të lejohen të dëgjojnë vetëm dëshminë.

29.7. Nuk është lejuar video apo audio incizimi i dëshmive të dëshmitarëve të cekur.

30. Pas lëshimit të urdhrit, të dhënat personale të dëshmitarëve të cekur janë hequr dhe shlyer nga dokumentet e gjykatës të cilat ishin në dispozicion të palëve dhe deklaratat e dëshmitarëve janë marrë nga prokuroria përmes video lidhjes ku dëshmitarët janë vendosë në një vend në largësi dhe nuk i kanë ekspozuar fytyrat e tyre para publikut.

31. Identiteti i të gjithë dëshmitarëve, të cilët kishin pseudonime ishte i njohur për palët.

32. Dëshmitari M nuk është paraqitur për gjykim për shkak se nuk ishte në dispozicion. Trupi gjykues ka mësuar sipas detyrës zyrtare se dëshmitari M është diagnostikuar si i paafte për të marrë pjesë në procedurë gjyqësore, siç është evidentuar në lëndën penale P 938/13.
33. Prokurori ka hequr dorë nga dëgjimi i dëshmitarit L dhe prandaj ai nuk është thirrur për gjykim.

#### **h. Karakteri publik i gjykimit**

34. Gjykimi është mbajtur në një gjykatë të hapur. Përveç përjashtimit të mundësisë për pjesëtarët e publikut që të shohin fytyrat e dëshmitarëve të dëgjuar përmes video konferencës, këto në vijim janë përjashtimet ndaj karakterit publik të gjykimit:

34.1.më 15 shtator 2014 seanca është mbyllur për pjesën e marrjes në pyetje tërthorazi të Dëshmitarit A, në mënyrë që të mbrohet anonimiteti i dëshmitarit;

34.2.më 20 mars 2015 seanca është mbyllur për dëshminë e Dr. **G. H.** mbi gjendjen mentale të dëshmitarit A, në mënyrë që të mbrohet privatësia e dëshmitarit A.

#### **V. Parimet e zbatuara gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve**



**a. Parashtrimi i pyetjeve sugjestive, provokuese, ngacmuese dhe të pyetjeve të tjera të ngjashme**

35. Ne parim, pyetjet sugjestive gjatë marrjes së drejtpërdrejt në pyetje nuk janë lejuar nga kryetari i trupit gjykues. Përjashtimet e vetme janë lejuar kur rikujtimi i fakteve nga dëshmitarët ishte shtjerrë së shfrytëzuar, kur ka pasur nevojë që të përqendrojnë vëmendjen e dëshmitarit për një çështje të caktuar ose kur pyetja e ka prekur ndonjë çështje e cila ishte e një njohurie të përgjithshme.
36. Pyetjet sugjestive dhe përsëritëse nuk janë lejuar në këtë fazë.
37. Ngacmimi i dëshmitarit si dhe citimi i gabuar i deklaratave të mëparshme nuk janë lejuar gjatë tërë marrjes në pyetje.

**b. Marrja në pyetje nga gjyqtarët**

38. Trupi gjykues ka marrë pjesë në mënyrë aktive në marrjen në pyetjet të dëshmitarëve në faza të ndryshme të marrjes në pyetje. Megjithatë, palët kanë pasur mundësinë që të sfidojnë përgjigjet e dhëna nga dëshmitari në pyetjet e gjyqtarit. Trupi gjykues e ka bazuar aktivitetin e tij të marrjes në pyetje në konkluzionin se neni 7 paragrafi 1 i KPPRK e obligon gjyqtarin që të kërkon të drejtën objektive. Prandaj, është dashur të bëhet një sqarim i përpiktë i të gjitha çështjeve faktike të cilat janë paraqitur para gjyqtarëve. Neni 299 paragrafi 1 i KPPRK i jep të drejtë gjyqtarit që t'i shtron pyetje cilido dëshmitar por nuk tregon se në çfarë faze të caktuar të marrjes në pyetje. Duket se Kodi nuk parasheh asnjë kufizim sa i përket kohëzgjatjes të marrjes në pyetje nga gjyqtarët.

**c. Udhëzimet të cilat i janë dhënë prokurorit lidhur me fushën e marrjes në pyetje**

39. Më 11 gusht 2014, pasi që prokurori e ka informuar dëshmitarin A mbi arsyet procedurale se ai nuk do të merrej në pyetje mbi faktet në lidhje me akuzat të cilat janë veçuar për procedurë ndaras , kryetari i trupit gjykues i ka dhënë udhëzimet në vijim:

*"Z. prokuror, ju i keni përmendur çështjet procedurale. Unë kuptoj se ju po i referoheni veçimit të procedurave. Unë e di sipas detyrës zyrtare se në rastin tjetër ju jeni pyetur që të mos hyni në hollësi të ngjarjeve të cilat i nënshtrohen këtyre procedurave, por kjo nuk do të thotë se përshkrimi i përgjithshëm i ngjarjeve tjera nuk është në interesin e këtij rasti. Nuk ka asgjë që ju pengon juve për parashtrimin e pyetjeve për tërë kohëzgjatjen e qëndrimit të dëshmitarit në \_\_\_\_\_. Në të vërtetë nuk mund të shmangët. Unë tashmë kam propozuar mënyrën kronologjike t. marrjes në pyetjet që do të ishte më shume e dobishme për gjykatën. Prandaj unë do të ju pyet më mirë që të sqaroni se çfarë ka ndodhë gjatë këtyre tre ditëve, sepse përndryshe ne nuk do ti paraqesim të dhënat të cilat i pranojmë në një rend të logjikshëm. Prandaj ju mund të pyesni pyetje në lidhje me tërë kohëzgjatjen e qëndrimit të dëshmitarit në \_\_\_\_\_ nëse është e rëndësishme për rastin e juaj."*

40. Avokati mbrojtës Bajram Tmava ka argumentuar se ky udhëzim e kishte tejkaluar të drejtën e kryetarit të trupit gjykues për të udhëhequr marrjen në pyetje. Ai ishte përkrahur nga avokati Artan Qerkini. Pas kundërshtimit të avokatit mbrojtës është paraqitë arsyetimi në vijim:

*"Ky kod procedural ka zbatuar një sistem të kundërt që është i ndryshëm nga sistemi i inkuizicionit. Bazohet në marrjen në pyetje të drejt për drejt dhe marrjen në pyetje tërthorazi të kryer nga palët. Por disa elemente bazike të sistemit të inkuizicionit ende mbeten. Kur ne e shikojmë nenin 7, detyra për të përcaktuar faktet*

*plotësisht të cilat janë të rëndësishme për vendimmarrje gjithashtu i përket gjykatës. Ekzistojnë dispozita të përgjithshme të cilat parashohin se gjyqtarët mund të parashtrojnë pyetje për sqarime dhe ekziston parimi i përgjithshëm në këtë Kod se gjyqtarët duhet të kërkojnë të vërtetën objektive.[...]*

*Ne mund të përcaktojmë faktet plotësisht në dy mënyra. Njëra është për të shtruar pyetjet vet, tjetra është për të pyetur palën e cila i shtron pyetjet për të sqaruar çështjen që është në interesin tonë. Prandaj unë them ndonjëherë se neve na nevojiten më shumë të dhëna, ose ndonjëherë i shtrojmë vet pyetjet.”*

41. Kur prokurori i drejtohet dëshmitarit:

*“Pas udhëzimeve të kryetarit të trupit gjykues, unë kam për t’iu parashtruar disa pyetje në lidhje me periudhën kohore në tri ditët e para gjatë qëndrimit tuaj.”*

42. Kryetari i trupit gjykues e ka udhëzuar prokurorin përsëri:

*“Vetëm nëse është i rëndësishëm për rastin tuaj. Unë nuk ju kam udhëzuar Prokuror që të veproni kështu, unë vetëm thash se ju nuk e keni të ndaluar që të shtroni pyetje për këtë periudhë kohore.”*

**d. Dëshmitari armiqësor**

43. Trupi gjykues i ka lejuar prokurorit që të shpallë dëshmitarin B si armiqësor dhe ta marrë atë në pyetje pa ndonjë kufizim të cilat zakonisht zbatohen gjatë marrjes së drejtpërdrejt në pyetje sa i përket parashtrimin të pyetjeve sugjestive dhe në përdorim të deklaratave të fazës paraprake. Palët janë udhëzuar që deklaratat e mëhershme të dëshmitarit nuk do të përdoren si prova të drejtpërdrejta. Pas kundërshtimit nga avokati mbrojtës Artan Qerkini, shpjegimi në vijim është dhënë më 9 dhjetor 2014<sup>1</sup> në lidhje me konceptin e dëshmitarit armiqësor të zbatuar nga gjykata:

*" Koncepti është gjerësisht i njohur në juridiksionin e ligjit zakonor ku sistemi i kundërshtimit është në fuqi. Nëse dëshmitari e mohon atë që ia ka thënë palës që e ka marrë në pyetje para gjykimit, nëse ai e kundërshton tezën se ai është dashur të përkrah dëshminë e tij para gjykatës së hapur, pastaj ai ka treguar armiqësi në rastin e palës. Zakonisht pala e cila e sponsorizon dëshmitarin duhet të kryen marrjen në pyetje të drejt për drejt. Janë disa kufizime serioze të cilat i caktohen palës gjatë marrjes në pyetje të drejt për drejt. Kjo ndodh për shkak se provat e paraqitura gjatë prezantimit marrjes në pyetje të drejt për drejt shërben si bazë e drejt për drejt për gjetjen e fakteve nga trupi gjykues. Prandaj është me rëndësi që dëshmitari të dëshmon atë që e din ai apo ajo spontanisht pa u udhëhequr. Kjo do të thotë se nuk lejohen pyetje drejtuese apo sugjestive. Ligjvënësit e Kosovës në nenin 334 paragrafi 4 i lejon për të përdorë deklaratën e dëshmitarit tjetër vetëm për të rifreskuar kujtesën e tij , pra nëse dëshmitari thotë "Mua nuk më kujtohet fakti", deklarata e tij e mëhershme mbi atë fakt mund të lexohet në gjykatë por ajo që lexohet nuk mund të përdoret si provë e drejt për drejt. Vetëm përgjigja e dëshmitarit pasi të rifreskohet kujtesa e tij mund të përdoret si provë.*

---

<sup>1</sup>Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor; 9 dhjetor 2014 f. 19.

Ligjvënësi i Kosovës e ka vendos një standard shumë të lartë për deklaratën e cila mund të lexohet para gjykatës. Në bazë të nenit 337 deklarata duhet të ruhet së paku në formë të dëshmisë, prandaj intervistat e procedurës paraprake nuk mund të lexohen.

Nëse dëshmitari jo vetëm se nuk e përmend faktin por ai i paraqet ato në mënyrë tjetër prej mënyrës që i ka paraqitë në procedurën paraprake, ri-freskimi i kujtesës së tij nuk lejohet. E vendos palën e cila e ka thirre dëshmitarin në një pozitë ku besueshmëria e dëshmitarit nuk mund të vihet në dyshim apo të sfidohet në asnjë mënyrë. Kjo përbën shkelje të parimit të barazisë së palëve pasi që provat paraqiten dhe pala nuk mund të lufton kundër tyre. Kjo është një zbrazëtirë e cila nuk është rregulluar me ligjin e Kosovës, dhe ne e gjemë atë se nuk përputhet me Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, kryesisht me nenin 6 që e kërkon gjykimin e drejtë. Koncepti i gjykimit të drejtë i përfshin edhe parimin e barazisë së palëve. Sa i përket të drejtës evropiane, barazia e palëve përfshin dhënien e mundësisë secilës palë për të paraqitë kauzën e tyre, në ato kushte të cilat nuk do ta vendosin këtë pjesë në situatë të pafavorshme kundër kundërshtarit të tij. Kushtetuta e Kosovës në nenin 22 parasheh për zbatimin e drejt për drejt të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut. Kjo është detyra jonë që të pajtohemi me standardet e Konventës. Prandaj ne mendojmë se koncepti i dëshmitarit të pafavorshëm është zgjidhja më e mirë.

Dëshmitari i pafavorshëm është dëshmitari i cili e mohon atë që ka thënë më parë. Pasi që dëshmitari të shpallet i pafavorshëm pala garantuese mund ta merr në pyetje pa kufizime të caktuara për marrje të drejtpërdrejt në pyetje. Por një marrje e atillë në pyetje nuk mund të përdoret për zbulimin e fakteve si provë e drejtpërdrejt. Mund të përdoret vetëm për t'i vënë në dyshim deklaratat të cilat përndryshe mund të

*konsiderohen si bazë për zbulimin e fakteve që duhet të vërtetohen nga gjykata. Çfarëdo që të jepet nga dëshmitari si përgjigje ndaj pyetjes sugjestive, ballafaqimi me deklaratën mëparshme, ose ballafaqimi me një provë tjetër e cila nuk duhet të përdoret në marrjen e drejtpërdrejt në pyetje nuk mund të përdoret si provë e drejtpërdrejt. Mund të shërbejë vetëm për vënien në dyshim të besueshmërisë së dëshmitarit.”*

#### **e. Video-konferenca**

##### **i. arsyetim**

44. Arsyetimi për përdorimin e video-konferencës u shpjegua në arsyetimin e aktvendimit për caktimin e masave mbrojtëse<sup>2</sup>:

*“Gjykata ka diskutuar të drejtën për gjykim publik, të drejtën për mbrojtje, dhe barazinë e kraheve, por gjithashtu edhe të drejtat personale të dëshmitarit për siguri personale. Të drejtat e mbrojtjes peshon ndaj të drejtës së dëshmitarëve dhe sigurisë së tyre, dhe të detyrës së shëtit për ta zbatuar drejtësinë. Gjykata e ka njohur të drejtën e ballafaqimit me dëshmitarët. Edhe pse është një komponent i rëndësishëm i një gjykimi të drejtë, nuk është e drejtë absolute pasi që siguria dhe mirëqeni e dëshmitarëve duhet të mbrohet.*

*I dimë sipas detyrë zyrtare disa shembuj të protestave publike kundër administrimit të drejtë të drejtësisë kundër ish luftëtarëve të \_\_\_\_\_ të grupit të \_\_\_\_\_.*

---

<sup>2</sup> Procesverbali nga shqyrtimi gjyqësor; 11 gusht 2014, f. 3.

*Një qëndrim i atillë lehtë mund të shkaktojë armiqësi kundre personave të cilët kanë dëshmuar në këtë rast. Nga kjo del nevoja për mbrojtjen e dëshmitarëve nga çdo akt armiqësor që mund të ndodhë. Gjykata supozon që të dhënat personale të dëshmitarëve tashmë janë të njohura për mbrojtjen. Sidoqoftë, nëse ato i zbulohen publikut dhe publikut i jepet rasti për t'i parë dëshmitarët, do të rritej rreziku i hakmarrjes ndaj tyre. Për më tepër, rreziku i frikësimit të dëshmitarit do të ishte më konkret.*

*Shkaku i natyrës së sofistikuar të video lidhjes mbrojtja do të mund të merrte pjesë në marrjen e tërthortë në pyetje dhe marrjen e drejtpërdrejt në pyetje të dëshmitarëve dhe do të mund të paraqesin prova në mënyrë të njëjtë siç do të ndodhte në gjykatore. Vendosija e video ekranit në atë mënyrë që vetëm gjykata dhe pala mund ta shohin dëshmitarin, do të na mundësonte ta respektonim të drejtën e gjykimit publik. Edhe pse publiku nuk do t'i sheh dëshmitarët, ata do të mund t'i dëgjojnë dëshmitë. Prania e personit juridik ose të një anëtari të stafit të gjykatës në lokacionin e largët, do të mundësonte identitetin e saktë të dëshmitarit, dhe lirinë e tij të flasë pa u detyruar ose pa udhëzime të paligjshme.*

## **ii. pajisjet**

45. Pajisjet e përdorura për video-konferencë ia mundësuan kolegjit dhe të pranishmëve të tjerë në gjykatore ta shihnin dëshmitarin e ulur në lokacion të largët, pjesën e epërme të trupit të tij. Dëshmitari mund ta shihte personin që e merrte në pyetje me kamerën e fokusuar në fytyrë dhe pjesën e epërme të trupit të personit që i

parashtronte pyetjet. Audio komunikimi dy-drejtimesh në kohë reale është mundësuar mes dëshmitarëve dhe personave në gjykatore. Zëri ka qenë i sinkronizuar me fotografinë. Në gjykatore është vendosur një ekran 54 inçesh (137 cm) për palët dhe për publikun ashtu që publiku nuk mund ta shihte personin që merrej në pyetje por vetëm mund ta dëgjonte atë.

### **iii. Ndhurma në lokacionin e largët**

46. Çdo dëshmitar që dëshmon në lokacion të largët është ndihmuar nga një zyrtar ligjor i EULEX-it ose nga një gjyqtar i EULEX-it. Roli i tyre ishte vetëm që të konfirmojnë identitetin e dëshmitarit dhe t'ia paraqesin dëshmitarit ndonjë provë që është përdorur në prova nëse ka pasur nevojë. Prania e tyre gjithashtu ishte menduar edhe si një mbrojtje për të siguruar se dëshmitari ka dëshmuar pa presion apo ndikim tjetër të papërshtatshëm. Asnjë ngjarje e tillë nuk ishte raportuar nga ndonjë prej personave ndihmës.
47. Gjatë dëshmisë së Dëshmitarit B ka qenë i pranishëm një përkthyes me të në një vend të largët për shkak të problemeve të dëgjimit të dëshmitarit. Të gjithë dëshmitarët e tjerë janë marrë në pyetje me ndihmën e përkthyesit të pranishëm në gjykatore.

### **f. Kundërshtimet e palëve ndaj veprimeve procedurale të ndërmarra nga trupi gjykues**

48. Avokati mbrojtës Bajram Tmava ka kërkuar të bëhet një audio regjistrim i dëshmisë së dëshmitarit A. Kjo kërkesë nuk është miratuar nga trupi gjykues me shpjegimin në vazhdim nga kryetari i trupit gjykues<sup>3</sup>:

---

<sup>3</sup> Procesverbali I shqyrtimi gjyqësor 15 shtator 2014, f. 2.



*"Ka momente kur shumë njerëz flasin njëkohësisht dhe momente kur kemi vështirësi për ta kapur atë që thotë dëshmitari. Nga përvoja ime, audio regjistrimi nuk e zgjidh problemin por kjo është një rrethanë normale, madje edhe në gjykatore. Nëse nuk mund ta kuptojmë të folurit e caktuar në një personi të caktuar në momentin kur ai është shprehur, nuk mund ta kuptojmë as nëse e kemi audio regjistrimin e të njëjtit."*

49. Artan Qerkini dhe Kadri Osaj kanë kundërshtuar ndaj identifikimit të **I. Th.** nga Dëshmitari A që u ishte urdhëruar nga kryetari i trupit gjykues më 17 nëntor 2014. Ata kanë argumentuar se vet identifikimi nuk përputhet me rregullat procedurale të parapara me KPPRK. Kryetari i trupit gjykues iu përgjigj kundërshtimeve në këtë mënyrë:

*"Është një teori e tërë ligjore për të ashtuquajturën "identifikimi në gjykatore" dhe aplikimi i saj në sistem të ndryshme ligjore duket të jetë i ndryshëm. Identifikimi në gjykatore është ai kur dëshmitari e identifikon të pandehurin në gjykatore si autorin e krimin të cilin dëshmitari e ka parë në vendngjarje."*

*Në disa juridiksione, marrja në pyetje e dëshmitarit fillon me pyetjen "a e njihni personin apo jo", në disa të tjera identifikimi në gjykatore rrallë pranohet. Të gjitha dispozitat që përfshihen nga ligjvënësi në kod duhet të kuptohen dhe interpretohen me fokusim në qëllimin e tij. Qëllimi është të pengohet identifikimi i gabuar. Nuk duhet të lejohet një situatë kur dëshmitari dëshmon "Nuk e kam parë të pandehurin kurrë më parë" dhe atij i tregohet personi në gjykatore për herë të parë. Kjo natyrisht do të ishte sugjeruese dhe mund të ketë efekte paragjyquese në identifikim. Kur e kemi një*

situatë që bazat për identifikim ekzistojnë dhe kur kjo është bërë pas marrjes së drejtpërdrejt në pyetje, nuk ka arsye të kihet frikë se identifikimi do të kishte ndonjë efekt paragjykues. Nuk e identifikojmë të pandehurin vetëm si autor krimi. Atë e identifikojmë si një person të cilin dëshmitari e ka njohur një kohë të gjatë. Duhet pasur parasysh që gjithçka që ka ndodhur në këtë gjykatore deri tash vetëm mund të jetë në dobi të të pandehurit. Po të kishte ndonjë dyshim se dëshmitari e ka njohur z. **I. Th.** para \_\_\_\_\_, jam i sigurt se do të kjo çështje ngrihej nga avokatët mbrojtës gjatë marrjes së tërthortë në pyetje. Dispozitat e KPK-së të cilave i referohet z. Qerkini janë të aplikueshme vetëm gjatë procedurës përgatitore. KPK-ja nuk e rregullon identifikimin e bërë gjatë procedurës përgatitore. Me sa duket ligji e lejon trupin gjykues të ketë liri veprimi në këtë çështje.”

50. Më 20 tetor, avokati mbrojtës Artan Qerkini ka kërkuar ta ndryshonte urdhrin për dëgjimin e dëshmitarëve dhe për ta dëgjuar Dëshmitarin B para Dëshmitarit K. Ai argumentoi se mund të ketë ndikim në vërtetimin e dyshimit të bazuar për çështjet që ndërliken me masat për sigurimin e pranisë së të akuzuarit. Parashtrësja është refuzuar nga trupi gjykues më 24 nëntor 2014 me këtë aktvendim të arsyetuar:

“E kemi refuzuar atë parashtrësë pasi që para së gjithash nuk lejohemi të bëjmë ndonjë vlerësim përfundimtar të provave. Në këtë fazë të procedurës trupi gjykues ka të drejtë vetëm në vlerësimin e ashtuquajtur *prima facie*, i cili kryesisht lejon refuzimin vetëm të provave të brendshme të pasigurta pa paragjykim të vlerësimit përfundimtar. Tash thuhet se ka prova që e fajësojnë të pandehurin lidhur me ekzistimin e dyshimit të bazuar.

*Edhe nëse e dëgjojmë ndonjë dëshmitari që do t'i mohonte ato që janë paraqitur në procedurën përgatitore nga dëshmitari, kjo nuk do të ndikonte në vlerësimin e përgjithshëm të dyshimit të bazuar sepse dëshmia e Dëshmitarit B nuk është vetëm provë fajësuese deri më tani. Andaj parashtresa është e pabazë."*

**g. Propozimet për nxjerrjen e provave të refuzuara nga trupi gjykues**

51. Më 28 janar 2015, prokuroria kërkoi të ftohet dëshmitari **C. S..** Prokurori kërkoi të përjashtohet publiku nga dëgjimi i dëshmitarit pasi që ai ishte \_\_\_\_\_ i \_\_\_\_\_ i cili merrej me krimet e luftës. Më 03 shkurt 2015, trupi gjykues e pranoi propozimin por e refuzoi kërkesën për përjashtimin e publikut dhe në vend të kësaj lejoi përdorimin e xhamit të errët.
52. Më 28 janar 2015, prokuroria ka propozuar që në shqyrtimin gjyqësor të lexohet deklarata e procedurës paraprake e Dëshmitarit M pasi që dëgjimi i dëshmitarit në gjykatore rezultoi të ishte i pamundur. Më 11 shkurt 2015, trupi gjykues e refuzoi këtë parashtresë në bazë të arsytimit në vijim:

*"Kjo deklaratë e procedurës paraprake është marrë në formën që duhet ta konsiderojmë si intervistë, sipas kodit të ri. Kjo do të thotë se palët dhe avokati mbrojtës nuk kanë pasur rast ta kundërshtojnë me marrje në pyetje. Kjo lloj dëshmie nuk mund të përdoret në shqyrtimin kryesor për qëllime të vërtetimit të fakteve. Ky interpretim është në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës së Apelit në rastin MPTP 1 (PN 577/2013, 10 dhjetor 2013). Akuzat kundër të pandehurve në gjykatë*

*duhet të mbështeten me prova të cilat ata kanë mundësi t'i kundërshtojnë. Kjo nuk e plotëson këtë kusht.*

#### **h. Provat e shqyrtuara gjatë shqyrtimit gjyqësor**

53. Provat materiale në vijim janë pranuar nga trupi gjykues:
- Prova 1: Prova 1 nga rasti nr. P 938/13 (certifikata mjekësore lidhur me Dëshmitarin A, e parashtruar nga Dëshmitari L gjatë seancës dëgjimore të datës 23 korrik 2014) është paraqitur si provë në këtë rast më 20 mars 2015.
  - Prova 2: lista e pjesëtarëve të \_\_\_\_\_ të brigadës \_\_\_\_ paraqitur nga Dëshmitari I. Xh. gjatë seancës më 12 shkurtit 2015;
  - Prova 3: dokumenti i parashtruar nga Dëshmitari R. S. gjatë seancës më 02 prill 2015 që i referohet faktit se ai ka qenë pjesëtar i \_\_\_\_\_ dhe kur është plagosur;
  - Prova 4: Aplikacioni për statusin e veteranit i parashtruar nga Dëshmitari A që është siguruar sipas detyrës zyrtare nga Gjykata pas parashtrësës së ushtruar nga avokati mbrojtës Artan Qerkini më 30 janar 2015;
  - Prova 5: kërkesa e **Z. D.** për statusin e veteranit është pranuar gjatë seancës më 20 mars 2015;
  - Prova 6: kërkesa e **D. D.** për statusin e veteranit parashtruar gjatë seancës së 23 prillit 2015;
  - Prova 7: kërkesa e **A. D.** për statusin e veteranit parashtruar gjatë seancës së 23 prillit 2015
54. Dëshmitarë në vijim janë intervistuar:
- Dëshmitari A më 11 dhe 12 gusht 2014, 15 dhe 16 shtator 2014, 10 tetor 2014, më 17 nëntor 2014;
  - Dëshmitari K më 24 nëntor 2014;
  - Dëshmitari B më 09 dhe 10 dhjetor 2014;
  - **Dëshmitari D më 11, 12, 13 dhe 18 nëntor 2014;**
  - **Dëshmitari I më 19 dhe 20 nëntor 2014;**
  - Dëshmitari B. G. më 15 dhjetor 2014;
  - Dëshmitari F. B. më 15 dhjetor 2014;
  - Dëshmitari ekspert doktor C. B. më 13 janar 2015;

- Dëshmitari C. S. më 11 shkurt 2015;
- Dëshmitari D. R. më 12 shkurt 2015;
- Dëshmitari B. V. më 12 shkurt 2015;
- Dëshmitari I. Xh. më 12 shkurt 2015;
- Dëshmitari S. M. më 12 shkurt 2015;
- Dëshmitari Dr. G. H. më 20 mars 2015;
- Dëshmitari R. S. më 02 prill 2015.

Të gjithë të pandehurit kanë shfytëzuar të drejtën e tyre t'u mbrojtur në heshtje.

## **B. Vërtetimi i gjendjes faktike**

55. Faktet relevante për akuzat se të pandehurit janë gjykuar në këtë lëndë janë vërtetuar nga trupi gjykues si rezultat i analizës dhe vlerësimit të të gjitha provave të paraqitura në gjykatore.

### **I. Faktet e përgjithshme lidhur me qëndrimin e Dëshmitarit A në \_\_\_\_\_**

56. Më \_\_\_\_ \_\_\_\_ \_\_\_\_ dy ushtarë të \_\_\_\_\_ kanë ardhur me një automjet terreni në shtëpinë e Dëshmitarit A. Ata e kanë parkuar automjetin afër derës dhe kishin hyrë në oborr. Ai ishte në oborr. Ata ishin në uniforma të kamufluara të \_\_\_\_\_ dhe kishin pushkë dhe revole.<sup>4</sup>

57. Ata ishin prezantuar si policë ushtarak dhe e kishin urdhëruar Dëshmitarin A të shkonte me ata duke thënë se kishin urdhër nga **S. S.** për ta çuar atë në \_\_\_\_\_ dhe se ai duhej të jepte deklaratë atje. Dëshmitari A iu kishte bindur atyre.<sup>5</sup>

58. Ushtarët e kishin pyetur Dëshmitarin A nëse e dinte se ku ishte shtëpia e Dëshmitarit B. Dëshmitari A kishte pohuar dhe ata e kishin çuar atje me veturë. Ishin

<sup>4</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 11 gusht 2014, f. 9.

<sup>5</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 11 gusht 2014 f. 9.

parkuar afër shtëpisë së Dëshmitarit B dhe kishin dalë nga vetura. Dëshmitarit A i thanë ta thërriste Dëshmitarin B që të shkonte me ata në \_\_\_\_\_ për të dhënë deklaratë. Ushtarët i dërguan Dëshmitarin B dhe Dëshmitarin A në \_\_\_\_\_.<sup>6</sup>

59. Në \_\_\_\_\_ Dëshmitarin A dhe Dëshmitarin B i futën në dhoma të ndara në ndërtesën e ish stacionit të policisë. Në atë kohë \_\_\_\_\_ e kishte shtabin atje. Ndërtesa ishte e dëmtuar nga bombat. Nuk kishte kulm por pllakë betoni.<sup>7</sup> Dhoma në të cilën ishte vendosur Dëshmitari A e kishte një dritare të vogël me grila dhe një dry dhe ajo dukej si qeli paraburgimi. Aty ishte një shtrat me zinxhir i cili ishte i lidhur për këmbët e drurit. Dera ishte e drurit. Ajo ishte e mbyllur me çelës nga jashtë.<sup>8</sup>
60. Të njëjtën ditë Dëshmitari A u mor në pyetje nga ushtarët e \_\_\_\_\_ **R. S.** dhe **M. Xh.. R. S.** ishte për lirimin e Dëshmitarit A por ushtari tjetër kundërshtoi.<sup>9</sup>
61. Rreth një orë më vonë, ushtarët e tjerë të \_\_\_\_\_ erdhën në dhomën e dëshmitarit A. Njëri prej tyre ishte Sh. Sh.. Ata e rrahën Dëshmitarin A me grushte dhe shqelma dhe e pyetën nëse e dinte se çka kishte thënë I. B. për atë. Dëshmitari A ra në dysheme. Në këtë moment katër ushtarë të tjerë hyrën brenda. Ata i kishin fytyrat e ngjyrosur. Ata gjithashtu e rrahën Dëshmitarin A derisa e humbi vetëdijen.<sup>10</sup>

<sup>6</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 11 gusht 2014 f. 9.

<sup>7</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 11 gusht 2014 f. 10.

<sup>8</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 11 gusht 2014 f. 10.

<sup>9</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 11 gusht 2014 f. 17.

<sup>10</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 11 gusht 2014 f. 17.

62. Pasi që ushtarët u larguan, **S. S.** hyri në dhomë. Ai ishte në rroba civile. I ra me shuplakë Dëshmitarit A derisa ai u këndell.<sup>11</sup>

63. Dëshmitar A nuk e njihte **S. S.. S. S.** i tha Dëshmitarit A se ai quhej '**S.**'. **S. S.** e hodhi atë në shtrat dhe vazhdoi ta rrihte.<sup>12</sup>

64. Gjatë ditëve të ardhshme, **S. S.** vinte në dhomën e Dëshmitarit A gati çdo ditë dhe e rrihte atë me shuplaka dhe grushte. Kjo vazhdoi derisa në lirimin e Dëshmitari A.<sup>13</sup>

65. Hollësitë e rrahjeve të kryera nga **S. S.** vetëm ishin objekt i pikës së aktakuzës e cila ishte veçuar dhe shqyrtuar në një procedurë tjetër.<sup>14</sup>

**II.** Rrahjet e përsëritura të Dëshmitarit A nga **S. S.**,  
**J. D.**, **I. Th.** dhe **Z. D.**.

66. Deri në fund të qëndrimit të Dëshmitarit A në \_\_\_\_\_, pothuaj çdo mbrëmje ose natë dy ushtarë e shoqëronin për në dhomën e madhe në të njëjtën ndërtesë, dhomë që dukej se përdorej si një qeli më e madhe e paraburgimit. Dhoma ishte 6 me 8 metra e madhe dhe nuk ishte e mobiluar. Nuk kishte rrymë aty andaj ndriçohej me 4 qirinj të vendosur nëpër këndet e dhomës.<sup>15</sup>

67. Në këtë dhomë të madhe Dëshmitari A është rrahur rregullisht nga një grup ushtarësh të përbërë nga 6 dhe ndonjëherë nga 8 persona. Katër prej tyre ishin **I. Th.**,

---

<sup>11</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 11 gusht 2014 f. 17.

<sup>12</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 11 gusht 2014 f. 17.

<sup>13</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 11 gusht 2014 f. 18.

<sup>14</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 11 gusht 2014 f. 18.

<sup>15</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 11 gusht 2014 f. 18.

**Z. D., J. D., S. S.**<sup>16)</sup>  
Dy personat e tjerë ishin **B. D.** dhe **D. M. D.**<sup>17</sup>  
Fajtorët e tjerë nuk u identifikuan gjatë gjykimit.

68. Ndonjëherë, disa nga ushtarët pjesëmarrës në rrahje bartnin maska. Ata ishin të armatosur me revole.<sup>18</sup>

69. Ushtarët i jepnin dajak Dëshmitarit A me radhë; dy prej tyre e keqtrajtonin përnjëherë, dhe pastaj ata zëvendësoheshin nga dy të tjerë. Ata e grushtonin dhe i binin me shuplaka dhe ndonjëherë përdornin edhe shkopinjë që dukeshin si të basebollit.<sup>19</sup> Dëshmitarin A ata e quanin "spiun".<sup>20</sup> Rrahjet zgjatnin 2 dhe 3 orë.<sup>21</sup> Një herë, **S. S.** i tha Dëshmitarit A se do t'ia nxirrte shpirtin me shkop.<sup>22</sup>

70. **S. S., I. Th., J. D.** dhe disa persona të tjerë i thoshin Dëshmitarit A se do ta vrisnin atë dhe do t'ia merrnin gruan dhe të bijën.<sup>23</sup>

71. **S. S.** i thoshte të tjerëve që ta mbysnin dëshmitarin A me shkopinjë.<sup>24</sup>

72. Njëri nga ushtarët tha në praninë e Dëshmitarit A:  
"Thirre **M. Xh.** t'ia heq kokën mu siç ia bëri **B.**"

---

<sup>16</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 11 gusht 2014 f. 18.

<sup>17</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 11 gusht 2014 f. 24.

<sup>18</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 11 gusht 2014 f. 19.

<sup>19</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 11 gusht 2014 f. 20.

<sup>20</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 11 gusht 2014 f. 29.

<sup>21</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 11 gusht 2014 f. 23.

<sup>22</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 11 gusht 2014 f. 25.

<sup>23</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 11 gusht 2014 f. 27.

<sup>24</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 11 gusht 2014 f. 29.



73. Ushtarët i drejtoheshin **S. S.** me "komandant" ose "**S.**"<sup>25</sup>

74. **S. S.** ishte i veshur me rroba civile. Ushtarët e tjerë kishin uniforma të ndryshme.<sup>26</sup>

### III. Rrahjet e njëkohshme të Dëshmitarit A dhe Dëshmitarit B

75. Rrahja e fundit e Dëshmitarit A dallonte nga e kaluara në mënyrë substanciale pasi që ai ishte rrahur bashkë me Dëshmitarin B. Kjo ndodhi në fillim të muajit \_\_\_\_\_ të vitit \_\_\_\_\_, rreth 10 ditë para se të lirohej Dëshmitari A.<sup>27</sup>

76. Dëshmitari A u shoqërua për në dhomë e njëjtë të madhe ku rrihej rregullisht në rastet e mëparshme. Aty ishin të pranishëm **A. D., B. D., D. D., S. D. 1., F. D., J. D., N. D., Z. D., S. S.,** dhe **I. Th.** Edhe këtë herë **S.S.** ishte në rroba civile ndërsa të tjerët ishin në uniforma. Aty ishte një person të cilin Dëshmitari A e njihte si **S. \_\_\_\_\_** i shtrirë në dysheme, në kënd dhe dukej të ishte rrahur rëndë.<sup>28</sup>

77. Disa nga të akuzuarit e pranishëm në dhomë ishin duke e rrahur Dëshmitarin B me grushte dhe shqelma. Ata gjithashtu përdornin edhe shkopinj druri për ta goditur atë. Kur Dëshmitari A hyri në dhomë ai gjithashtu u rrah në të njëjtën mënyrë. **I. Th.** ishte i pari që e goditi. Ai gjithashtu e shau Dëshmitarin A me nënë dhe e kërcënoi me vdekje. Njëri nga të akuzuarit i derdhi ujë me kovë Dëshmitarit B.<sup>29</sup>

<sup>25</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 12 gusht 2014 f. 3.

<sup>26</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 12 gusht 2014 f. 9.

<sup>27</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 15 shtator 2014 f. 16 dhe 17.

<sup>28</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 15 shtator 2014 f. 9.

<sup>29</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 15 shtator 2014 f. 9.

78. Në një çast të caktuar, **I. Th.** ia dha shkopin e drurit Dëshmitarit dhe e urdhëroi atë që ta rrihte Dëshmitarin A. **I. Th.** u kërcënua se që të dy, Dëshmitarët A dhe B do të ekzekutoheshin nëse Dëshmitari B do të refuzonte. Dëshmitari B e goditi Dëshmitarin A në pjesën e prapme të trupit disa herë.
79. Pas kësaj **I. Th.** ia dha një shkop Dëshmitarit A dhe e urdhëroi t'ia bënte të njëjtën gjë Dëshmitarit B Dëshmitari A refuzoi.<sup>30</sup>
80. Dëshmitari A dhe Dëshmitari B u rrahën në dhomën e madhe nga të gjithë të akuzuarit rreth 3 orë.<sup>31</sup> Të akuzuarit vepronin me radhë; derisa disa nga ata i rrihnin viktimat, të tjerët shikonin. Pastaj, i ndërronin rolet.
81. Si rezultat i rrahjeve, Dëshmitari A ra në dysheme. Njëri nga të akuzuarit e pickoi me një mjet të hekurt në herdhe duke i shkaktuar dhembje të madhe dhe plagë. Pas kësaj, Dëshmitarin A e çuan në dhomën e tij dhe e lanë atje.<sup>32</sup>

**IV. Faktet e tjera lidhur me akuzat që kanë të bëjnë me ngjarjet që ndodhën në \_\_\_\_\_**

82. Para arritjes së Dëshmitarëve A dhe B në \_\_\_\_\_, trupat \_\_\_\_\_ e bombarduan këtë vend me artileri.<sup>33</sup>
83. Fshati i Dëshmitarit A u sulmua nga \_\_\_\_\_ më \_\_\_ ose \_\_\_\_\_<sup>34</sup>.

<sup>30</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 15 shtator 2014 f. 12.

<sup>31</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 15 shtator 2014 f. 8.

<sup>32</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 15 shtator 2014 f. 15.

<sup>33</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 11 gusht 2014 f. 10.

<sup>34</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 24 nëntor 2014 f. 25.

84. Dëshmitari A nuk mori pjesë në veprimet ushtarake. Pas luftës ai aplikoi për statusin e personit që i ka ndihmuar \_\_\_\_\_.<sup>35</sup>
85. Në \_\_\_\_\_ të vitit \_\_\_\_\_, **B. D.** shërbeu në Brigadën \_\_\_\_\_ të \_\_\_\_\_ bashkë me **B. V.** dhe **D. R..** Brigada përbëhej nga tre kompani dhe secila kompani përbëhej nga dy apo tre togje. Brigada ishte vendosur në fshatin e quajtur \_\_\_\_\_ që ndodhet në largësi prej 2 deri 3 km nga \_\_\_\_\_. **B. V.** dhe **B. D.** shërbenin ne togje të ndryshme. Ushtarët jetonin në kazerma. Aty aplikoheshin disiplina ushtarake. Nuk lejoheshin të largoheshin nga kazermat pa leje dhe çdo mëngjes lexoheshin emrat e tyre për ta vërtetuar praninë e tyre.<sup>36</sup>
86. Në \_\_\_\_\_ të vitit \_\_\_\_\_, **F. D.** ka pësuar një lëndim në njërën krah të tij, shkaktuar nga një granatë dore. Ai është rekomanduar nga mjeku **F. B.** që të mos e përdor krahun e plagosur për tre muaj dhe t'i nënshtrohet rehabilitimit.<sup>37</sup>
87. Si rezultat i rrahjeve që i ka përjetuar Dëshmitari A në \_\_\_\_\_, ai ka pësuar lëndime të ndryshme: mavijosje në tërë trupin duke përfshirë edhe kokën, dhe brinjë të thyera. Ai ka pësuar një plagë në skrotum gjatë incidentit kur është rrahur bashkë me Dëshmitarin B.<sup>38</sup> Përveç kësaj plage, nuk ka pasur baza për t'i atribuar lëndime të caktuara veprimit konkret të kryer nga i akuzuari.
88. Për ca kohë kishte persona tjerë të burgosur në të njëjtën dhomë me Dëshmitarin A: **F. M.**, dhe **H. M.**, dhe **G. V.. F. M.**, dhe **H. M.** kanë qëndruar për disa ditë dhe janë liruar më herët se

<sup>35</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 16 shtator 2014 f. 14.

<sup>36</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 12 shkurt 2015 f. 3 dhe 6.

<sup>37</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 15 dhjetor 2014 f. 27 dhe 28.

<sup>38</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 15 shtator 2014 f. 16.

Dëshmitari A. **G.V.** ka qëndruar me Dëshmitarin A derisa janë liruar së bashku.<sup>39</sup>

89. Përveç personave të lartcekur, kishte edhe persona tjerë të burgosur në \_\_\_\_\_ gjatë qëndrimit të Dëshmitarit A, për një kohë të pacaktuar: tre vëllezër nga \_\_\_\_\_, një burrë nga fshati \_\_\_\_\_ i \_\_\_\_\_, një burrë nga vendi i quajtur \_\_\_\_\_ e \_\_\_\_\_ dhe një mësues nga \_\_\_\_\_.<sup>40</sup> Nuk ka baza për të vërtetuar se sa kohë kanë qëndruar aty dhe si janë trajtuar.
90. Ndërmjet datave \_\_ dhe \_\_ \_\_\_\_\_, ka filluar ofensiva e forcave \_\_\_\_\_, shoqëruar me granatime. Në atë kohë ushtari i \_\_\_\_\_ **R. S.** e ka hapur dhomën ku janë mbajtur Dëshmitari A dhe **G. V.** dhe i ka lënë të shkojnë.<sup>41</sup>
91. Për shkak të ofensivës \_\_\_\_\_ janë lënduar shumë njerëz si pasojë e granatimeve. Rreth 4000 refugjatë kanë kërkuar strehim.<sup>42</sup>

### **c. Vlerësimi i provave**

#### **I. Provat që janë përdorur si bazë për rekonstruimin e fakteve**

##### **a. Provat plotësisht të besuara**

92. Shumica e të gjeturave faktike nga trupi gjykyes është bazuar në dëshmitë e Dëshmitarit A dhe Dëshmitarit K.

---

<sup>39</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 17 nëntor 2014 f. 22.

<sup>40</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 17 nëntor 2014 f. 22.

<sup>41</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 15 shtator 2014 f. 17 dhe 21.

<sup>42</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 15 dhjetor 2014 f. 10.

93. Ishte e qartë se ata nuk kishin përvojë në dhënien e një versioni të saktë dhe mirë të strukturuar të ngjarjeve. prandaj, deklaratat e tyre përmbanin ngecje dhe zbrazëtira të cilat trupi gjykues ua atribuon aftësive të kufizuara raportuese të dëshmitarëve dhe jo mashtrimit të qëllimshëm.
94. Dëshmitë e Dëshmitarit A dhe Dëshmitarit K plotësojnë njëra tjetrën dhe nuk kundërshtojnë njëra tjetrën. Dëshmitë ishin reciprokisht konfirmuese në raport me elementet qenësore.

### **Dëshmitari A**

95. Dëshmia e Dëshmitarit A është paraqitur si provë vendimtare për rekonstruimin e fakteve që kanë ndodhur në \_\_\_\_\_.
96. Ishte çështja e çrregullimit të prezumuar mendor që Dëshmitari A nga i cili ka mundur të vuante Dëshmitari A. Kjo është sjellë në vëmendjen e trupit gjykues përmes një certifikatë mjekësore e datës \_\_\_\_\_ dhe e deponuar si provë materiale në P 938/13, dhe nga dëshmia e Dr. G. H..
97. Pas shqyrtimit të përpiktë të deklaratës së Dëshmitarit A, trupi gjykues nuk pati dyshime lidhur me aftësinë e tij për të kuptoj, rikujtoj dhe paraqes faktet për të cilat ishte dëshmitar.
98. Trupi gjykues ka përjashtuar mundësinë e mashtrimeve të paraqitura nga Dëshmitari A si fakte. Rrëfimi i Dëshmitarit A i ngjarjeve nuk përmban ndonjë element që do mund të kundërshtohet nga njohuria e përgjithshme apo nga mendimi praktik. Ai ishte bindës, i besueshëm, i qëndrueshëm në vetvete dhe prandaj ishte kredibël. Ai i

ka kuptuar pyetjet dhe ka dhënë përgjigje që kishin të bënë saktësisht me çështjet për të cilat ishte pyetur.

99. Nuk ka pasur mospërputhje në përgjigjet e tij megjithëse është pyetur disa herë për të njëjtat çështje.
100. Avokatët mbrojtës kanë paraqitur disa sfida për besueshmërinë e Dëshmitarit A.
101. Dëshmitari A ka treguar shkallë të ndryshme të theksimit të veprimeve të kryerësve të caktuar. Kjo ka treguar përpjesëtim ndërmjet vuajtjes që ka pësuar dhe kujdesit që u ka kushtuar kryerësve individualë.
102. Trupi gjykues i ka kushtuar vëmendje të përpiktë faktit që Dëshmitari A ka mohuar se kishte marrë certifikatë mjekësore e cila e kishte shpallur atë të pa aftë për punë. Dëshmia e tij është kundërshtuar nga certifikata mjekësore dhe nga dëshmia e Dr. G. H., Dëshmitari ka vuajtur nga psikoza akute në kohën kur e ka marrë certifikatën. Ajo mund të rezultojë në pengim në perceptimin e fakteve. Trupi gjykues erdhi në përfundim se simptomat që duket se i ka vërejtur Dr. G. H. në kohën e ekzaminimit të Dëshmitarit A kanë mundur t'ia pamundësonin Dëshmitarit A ta kuptojë rëndësinë e përmbajtjes së dokumentit. Dokumenti ishte në posedim të vëllait të Dëshmitarit A, dhe nuk është vërtetuar se Dëshmitari A të kishte mësuar ndonjëherë përmbajtjen e tij, ndërsa simptomat e psikozës akute kanë pushuar së ekzistuari.
103. Asnjë nga faktet e paraqitura nga Dëshmitari A nuk është kundërshtuar me ndonjë provë tjetër që është gjetur nga trupi gjykues si plotësisht e besueshme, në veçanti: dëshmia e Dëshmitarit K, dhe mendimi prej eksperti i Dr. C. B..

## Dëshmitari K

104. Dëshmia e Dëshmitarit K ka vërtetuar dëshminë e dhënë nga Dëshmitari A sa u përket fakteve në vijim: ai ishte marrë nga shtëpia e tij nga ushtarët e \_\_\_\_\_, ai ka qëndruar larg shtëpisë për afërsisht një muaj dhe ishte kthyer në shtëpi i lënduar.
105. Përshkrimi i saj i lëndimeve të pësuar nga Dëshmitari A përputhet me deklaratën e tij.
106. Mënyra se si fliste Dëshmitari K në sallën e gjykimit tregonte spontanitet. Nuk kishte as fakte joreale të rrethanave as elemente që kundërshtonin rrëfimin e dëshmitarit A në deklaratën e saj.
107. Dëshmitari K nuk ka përmendur se ushtarët të cilët e kishin marrë Dëshmitarin A i kishin thënë atij se ata kishin zbatuar urdhrat e **S. S.** siq ishte raportuar nga Dëshmitari A. Kjo ngecje paraqitet si rezultat i kohës së kaluar dhe pa përsosmërisë së kujtesës njerëzore. Me sa duket, ajo dhe bashkëshorti i saj u kanë atribuar shkallë të ndryshme të rëndësisë rrethanave të ndryshme të arrestit.
108. Dëshmitari K nuk e ka njohur **S. S.** as nuk e ka ditur pozitën e tij në atë kohë. Ajo nuk ka komunikuar vetë me ushtarët. Prandaj, duket e natyrshme që emri nuk i ka mbetur në kujtesë.
109. Kjo ngecje megjithatë ka bindur trupin gjykues se Dëshmitari K nuk është konsultuar dëshminë e saj me

Dëshmitarin A dhe se ajo nuk kishte për qëllim ta fajësonte **S. S.** .

**Dëshmitarja në cilësi eksperti C. B.**

110. Observimet dhe të gjeturat e paraqitura nga dëshmitarja në cilësi eksperti Dr. C. B. ishin në përputhje me deklaratën e Dëshmitarit A.
111. Ekspertiza e Dr. C. B. ë fushën e mjekësisë ligjore është vërtetuar fuqimisht me prezantimin e të kaluarës së saj akademike dhe përvojën. Te gjeturat e janë bazuar në ekzaminimin mjekësor të cilën e kishte bërë ajo vetë. Vetëm ekzaminimi i plagës që gjendet në zonën gjenitale të trupit të Dëshmitarit A është bërë nga Dr. M. G..
112. Në vlerësimin e tij mjekësor të lexuar në gjykatë, Dr. M. G. ka paraqitur një përshkrim të qartë, të saktë dhe të hollësishëm dhe nuk kishte dyshime sa u përket kualifikimeve të tij si mjek i mjekësisë ligjore.
113. Trupi gjykues nuk kishte dyshime lidhur me besueshmërinë e raporteve të Dr. C.B. dhe Dr. M. G.. Përfundimet e paraqitura nga Dr. C. B. në sallën e gjykimit ishin tërësisht bindëse.
114. Trupi gjykues ka ardhur në përfundim se vetëm vërraga në skrotum mund t'i atribuohet veprimit konkret të të akuzuarit. Nuk kishte tregues vendimtar se cilat të rrahura kishin rezultuar në ndonjërin nga plagët tjera të caktuara.
115. Vlerësimi i përgjithshëm se mendimi i Dr. C. B. vërtetoi se dëshmia e Dëshmitarit A nuk ishte dëmtuar nga diskursi i saj se vërragët në fjalë kanë mundur të rrjedhin nga ngjarje tjera nga ato që paraqiten nga dëshmitari. Vërtetimi në këtë rast nuk ishte as përfundimtar as vendimtar por mendimi nuk e ka diskredituar dëshmitarin në asnjë mënyrë. Prandaj, ishte



logjika, koherenca dhe mungesa e mospërputhjes me prova tjera të besueshme që ka kontribuar në vlerësimin pozitiv të vlerës dëshmuese të dëshmitave të Dëshmitarit A dhe Dëshmitarit K.

116. Është vështrim i përgjithshëm se mendimet e ekspertëve të mjekësisë ligjore shpesh bazohen në thashetheme d.m.th. në anamnezën që vjen nga pala e dëmtuar. Trupi gjykues vuri re se në këtë rast anamneza ishte vërtetuar: përshkrimi i vërragëve dhe i origjinës së tyre dhënë mjekës Dr. C. B. nga Dëshmitari A gjatë ekzaminimit ka korresponduar plotësisht me deklaratën e Dëshmitarit A dhënë në gjykatë.

117. Një mospërputhje tjetër lidhej me karakteristikën e plagës në skrotum. Dëshmitari A i referohet plagës si : e hapur".<sup>43</sup> Ekzaminimi që është bërë më 21 shtator 2012 ka treguar se plaga ishte shëruar dhe kishte mbetur një vërragë e dukshme. Këtë mospërputhje trupi gjykues ua atribuon aftësive të ulëta dhe të kufizuara linguistike të dëshmitarit A. Ai shprehej në një mënyrë pa nuanca.

#### **Kërkesa e Dëshmitarit A për statusin e veteranit të \_\_\_\_\_**

118. Kërkesa e Dëshmitarit A për statusin e veteranit të \_\_\_\_\_ e datës \_\_\_\_\_ është vërtetuar si duhet. Ajo është prezantuar me kërkesë të gjykatës nga organi kompetent: Komisioni Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të Veteranit, invalidit dhe të internuarit të \_\_\_\_\_.

119. Dëshmitari A ka konfirmuar në sallën e gjykimit se kërkesën e kishte parashtruar vetë duke pohuar se e kishte bërë këtë si dikush që e kishte ndihmuar \_\_\_\_\_.<sup>44</sup>

<sup>43</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 15 shtator 2014 f. 16.

<sup>44</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 16 shtator 2014 f. 14.

120. Përmbajtja e kërkesës ka kontribuar në gjetjen se Dëshmitari A nuk ishte ushtar i \_\_\_\_\_ dhe nuk kishte marrë pjesë në veprime ushtarake.

**b. Supozimet dhe faktet e njohura të miratuara nga trupi gjykues**

121. Trupi gjykues ka pranuar supozimin se Dëshmitari B as nuk shërbyer në \_\_\_ as nuk ka marrë pjesë në veprime ushtarake. Kjo është bazuar në vlerësimin se asnjë provë nuk ka treguar se ai ishte ushtar apo se ishte i përfshirë në luftime apo në forma tjera të veprimeve ushtarake lidhur me konfliktin e armatosur. Është fakt i pamohueshëm se shumica e \_\_\_\_\_ të \_\_\_\_\_ u ishin ekspozuar mizorive të shkaktuara nga konflikti. Jo të gjithë kanë marrë pjesë aktive në veprime ushtarake megjithëse shumica syresh kanë mundur ta mbështesnin \_\_\_\_\_ në forma tjera të ndryshme.

122. Lëndimi në njërin krah nuk e ka parandaluar **F. D.** të marrë pjesë në rrahjen e Dëshmitarit A. Ky përfundim është arritur në bazë të rrëfimit të Dëshmitarit A. Dëshmitari A nuk ka dhënë ndonjë hollësi sa i përket përshtimit të veprimit të kryer nga **F. D.** në atë rast që do të përfshinte përdorimin e armëve. Ai vetëm ka deklaruar se **F. D.** ka marrë pjesë në rrahje.

123. Është pranuar si fakt i pamohueshëm se në kohën kur Dëshmitari A është mbajtur në \_\_\_\_\_, në Kosovë po ndodhte një konflikt të armatosur. Ka pasur viktima të shumta, dëme të pasurisë, dhe zhvendosje të civilëve. Ky fakt i pamohueshëm përforcohet nga faktet e paraqitura nga Dëshmitari A dhe Dëshmitari K dhe gjithashtu edhe nga **F. B.** dhe **B. G.**

124. Që nga lufta të gjithë të akuzuarit kanë jetuar në mënyrë të ndershme. **S. S.** shërben si ambasador në \_\_\_\_\_, **N. D.** është \_\_\_\_\_ i \_\_\_\_\_ së \_\_\_\_\_, dhe

**F. D.** është \_\_\_\_\_. **I. Th.** i ofron mbrojtje personale një zyrtari qeveritar.

**c. Provat e besueshme por jo përfundimtare**

**Dëshmitari Dr. G. H.**

125. Dr. G. H. ka dhënë dëshmi në cilësi të dëshmitarit lidhur me faktet rreth lëshimit të certifikatës për shëndetin e Dëshmitarit A.
126. Trupi gjykues e ka gjetur të besueshme se Dr. G. H. kishte lëshuar certifikatën e cila përmbante diagnozën se Dëshmitari A vuante nga psikoza akute dhe ishte i pa aftë për punë. Kjo provë nuk është përfundimtare sepse trupi gjykues ka ardhur në përfundim se ajo nuk vërteton se aftësia e Dëshmitarit A për të dhënë dëshmi të besueshme ishte dëmtuar.
127. Dr. G. H. nuk i është kujtuar ekzaminimi i Dëshmitarit A. Ai ka treguar se Dëshmitari A dhe disa anëtarë të familjes së tij kishin qenë pacientë të tij para lufte.
128. Dr. G. H. ka paraqitur të kuptuarit e tij për psikozën akute si në vijim:

*Psikoza akute është çrregullim mendor apo një nga nënllojet e skizofrenisë që manifestohet apo definohet sipas nocionit DSM 4 dhe ICD 10.[...] njihet si çrregullim skizofrenik apo episod psikotik me elemente psikogjenike.*

Për diagnozën e psikozës akute, pacienti është i çorientuar me vetën dhe rrethin e tij. Tek ata pacientë, preken disa nga zonat mendore, e sidomos zona mendore atakohet dhe ajo kognitive, pastaj zona e të menduarit, perceptuarit, e vullnetit dhe i tërë personi është i paorganizuar. Në rastin e dhënë, zonat më të prekura janë zonat e të menduarit; në këtë rast, personi bëhet deziluzional.

[...] Nën psikozën akute, sulmohen zonat e të menduarit dhe më së shumti kjo nxit çrregullimin deziluzional . Personi mendon se dikush tjetër udhëheq idetë e tij, i urdhëron të mendojë, se dikush tjetër i përsërit idetë e tij, dhe njëkohësisht ekziston një ndjesi e grandiozitetit, apo ndjesitë e tij se ai është person i gjithëfuqishëm/ grandioz. Pastaj ndjesia e persekutimit dhe të pranishme janë edhe halucinacionet që mund të jenë të llojeve të ndryshme, si ato të llojit auditiv, që ai dëgjon zëra të ndryshëm, vizual, që do të thotë se ai sheh pamje jo ekzistente, dhe gjithashtu prekëse, zgjedhëse dhe gjithashtu se dikush po i dëmton pjesët e trupit. Pra kemi një çrregullim personaliteti i cili nuk përshtatem me rrethi real, të jashtëm apo të brendshëm.<sup>45</sup>

129. Është shpjeguar se definicioni i paraqitur nga dëshmitari nuk i referohet asnjë simptome konkrete që do ta gjente dëshmitari gjatë ekzaminimit<sup>46</sup>:

"Kryetari i trupit gjykues: Kur thoni në këtë rast, a i referoheni pacientit të caktuar?

G. H.: Unë vetëm i referohem psikozës akute."

---

<sup>45</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 20 mars 2015 f. 7.

<sup>46</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 20 mars 2015 f. 7.

130. Ai gjithashtu ka shpjeguar se psikoza akute zakonisht ndodhë për një kohë të kufizuar kohore.

*"Siç thashë, psikoza akute ka zhvillim mjaft të shpejtë. Kjo është arsye që quhet psikozë akute. Ajo mund të zgjasë afërsisht një muaj ( katër javë) por mbrëmë unë kam konsultuar ca literaturë dhe aty thuhet se kjo gjendje mund të zgjasë deri në 6 muaj dhe gjatë kësaj gjendje mendore gjatë tërë kohës mund të paraqiten deziluzione."*

131. Trupi gjykues e ka refuzuar certifikatën e lëshuar nga Dr. G. H. më \_\_\_\_\_ si provë që Dëshmitari A ka vuajtur nga e meta mendore qoftë kur ka qenë dëshmitar i ngjarjeve në \_\_\_\_\_ qoftë kur ka dhënë dëshminë për shkak të kësaj në vijim:

132. Dr. G. H. e ka pranuar se definicioni të cilin e ka paraqitur në sallën e gjykimit pjesërisht ishte i bazuar në leximin e literaturës që e kishte bërë në mbrëmjen para se të vinte në shqyrtim gjyqësor, Kjo ka e bërë kuptimin origjinal të diagnozës së zbatuar nga Dr. G. H. më \_\_\_\_\_ të paqartë. Prandaj, nuk ka gjetur se ka nevojë të ekzaminojë nëse të kuptuarit e Dr. G. H. për psikozën akute përputhet me definicion e rëndomtë të këtij çrregullimi.

133. Dr. G. H. nuk i ka paraqitur rrethanat e lëshimit të certifikatës. Certifikata ishte tejet e përmbledhur. Ajo nuk përmban asnjë raport mbi historikun, trajtimin mjekësor dhe madje as përshkrimin e sindromave përkundër pasojave shumë të rënda që do mund t'i shkaktonte, në veçanti paaftësisë së Dëshmitarit A për punë.

134. Trupi gjykues ka besuar se gjatë ekzaminimit më \_\_\_\_\_, Dëshmitari A ka demonstruar ca simptome të psikozës akute si ato që i përshkruan Dr. G. H. që janë tipike për diagnozën të cilën mjeku e ka vënë në certifikatë. Megjithatë, trupi gjykues ka vërejtur se

gjatë shqyrtimit gjyqësor Dëshmitari A nuk ka manifestuar asnjë simptome të tillë. Analiza e përmbajtjes intelektuale të dëshmisë së Dëshmitarit A nuk ka zbuluar ndonjë indikacion për ndonjë të metë që do mund të bënte që aftësia e tij për të kuptuar, perceptuar, mbajtur mendë dhe rikujtuar faktet për të cilat kishte qenë dëshmitarë të zbehej në çfarëdo mënyre.

#### **Dëshmitari C. S.**

135. Trupi gjykues ka gjetur se dëshmia e dëshmitarit C. S. është plotësisht e besueshme por vetëm si provë që Dëshmitari B ka raportuar tek ai shqetësimet lidhur me sigurinë e tij personale dhe jo si provë e fakteve të paraqitura nga Dëshmitari B. Dëshmia e tij nuk përmban ndonjë që do mund të ishte joreale.

136. Rrëfimi i dëshmitari C. S. përputhet me sjelljen e Dëshmitarit B në sallën e gjyqimit. Dëshmitari B ishte dukshëm i shqetësuar, i pa sigurt dhe i frikësuar. Megjithatë, nuk ka pasur baza të vërtetohet vërtetësia e pretendimeve të Dëshmitarit B dhe besueshmëria e dëshmisë së tij tashmë ishte diskredituar për arsye tjera.

#### **Dëshmitari Dr. F. B.**

137. Gjykata ka pranuar dëshminë e Dr. F. B. si tërësisht të besueshme. Ai ka dëshmuar në mënyrë spontane dhe nuk iu është shmangur përgjigjes në pyetje. Megjithatë, ai nuk ka paraqitur rrethanat të cilat do të mohonin apo konfirmonin të gjeturat e trupit gjykues lidhur me faktet që kanë të bëjnë me akuzat. Dukej se ai nuk kishte mundësi të bënte vështrimet në ndërtesën e shtabit të \_\_\_\_\_ ku kanë ndodhur të rrahurat.

138. Ai ka konfirmuar se ka pasur përleshje serioze të armatosura ndërmjet trupave \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ dhe se shumë njerëz kanë pasur nevojë për ndihmë mjekësore. Ai gjithashtu ka konfirmuar se e kishte parë **S. S., Z. D., J. D.** dhe **I. Th.** në \_\_\_\_\_ në vitin \_\_\_\_\_; megjithatë ai nuk i kishte parë ata të kenë qenë të përfshirë në ndonjë incident që do mund të lidhej me akuzat.

139. Ai ka mohuar se kishte parë të akuzuarit tjerë aty. Fakti se ai nuk i kishte parë ata në \_\_\_\_\_ mund të bie ndesh me deklaratën e Dëshmitarit A me që nuk përjashton praninë e tyre në vend vetëm për një kohë të shkurtë apo madje edhe vetëm natën kur i kishin rrahur Dëshmitarin A dhe Dëshmitarin B.

**Dëshmitari Dr. B. G.**

140. Dëshmitari Dr. B. G. ka dëshmuar në mënyrë të sigurtë dhe të qartë. Nuk kishte baza për ta mohuar vërtetësinë e tij. Deklarata e tij nuk përmban ndonjë element që do lidhej drejtpërdrejt me akuzat.

141. Dr. B. G. i ka përkujtuar faktet që lidhen me ofensivën \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_ të \_\_\_\_\_, kur ishin plagosur shumë njerëz dhe rreth 4000 refugjatë kërkonin strehim.

**d. Provat e refuzuara si bazë e rekonstruimit të fakteve**

**Dëshmitari B**

142. Trupi gjykues ka gjetur se dëshmia e Dëshmitarit B nuk është e besueshme, me përjashtim të faktit se ishte sjellë në \_\_\_\_\_ bashkë me Dëshmitarin A. Dëshmitari B i ka mohuar deklaratat e tij nga faza e procedurës paraprake pothuajse në tërësi.

143. Ai e ka filluar dëshminë e tij me informatën se ndihet i kërcënuar për shkak të qenit dëshmitar në këtë lëndë. Ai ka thënë se identiteti i dëshmitarit është ekspozuar.

144. Si përgjigje në pyetjen e prokurorit lidhur me pjesën e deklaratës së tij:

*"A është ky shembull që ju e ndërroni dëshminë sepse jeni i frikësuar?"*

145. Dëshmitari B e ka pranuar këtë.<sup>47</sup>

146. Ishte e dukshme për trupin gjykues se Dëshmitari B frikësohej dukshëm që ta thoshte të vërtetën.

147. Rrëfimi i Dëshmitarit B për arrestimin e tij dallon dukshëm nga deklarata e Dëshmitarit A. Dëshmitari B pretendon se Dëshmitari A kishte vepruar në bashkëpunim me dy ushtarë të \_\_\_\_\_ dhe kishte veshur uniformë të \_\_\_\_\_ dhe ishte i armatosur me një armë. Këto pretendime ishin tërësisht joreale pasi që nuk mbështeteshin nga ndonjë provë tjetër dhe ato bien ndesh me deklaratat e Dëshmitarit A dhe Dëshmitarit K.

148. Në disa raste Dëshmitari B iu ka shmangur përgjigjes në pyetje sepse thoshte se frikohej të përgjigjej.<sup>48</sup>

---

<sup>47</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 9 dhjetor 2014 f. 10.



149. Fakti që Dëshmitari B frikohej të dëshmonte është vërtetuar nga Dëshmitari C. S..
150. Tregimi i datave i Dëshmitarit B del të jetë i gabuar. Ai ka përcaktuar se ishte sjellë në \_\_\_\_\_ më \_\_\_\_\_ . Pastaj ai spontanisht ka thënë se kjo kishte ndodhur më \_\_\_\_\_ .<sup>49</sup> Dëshmitari A bindshëm ka deklaruar se ishte sjellë në \_\_\_\_\_ bashkë me Dëshmitarin B më \_\_\_\_\_ .
151. Deklaratat e Dëshmitarit B lidhur me kohëzgjatjen e qëndrimit të tij në \_\_\_\_\_ dhe mohimi i tij se ishte i përfshirë në incident kur ishte keqtrajtuar bashkë me Dëshmitarin A ishin në kundërshtim me dëshminë e dëshmitarit A.
152. Pretendimet e Dëshmitarit B lidhur me falsifikimin e deklaratës së tij të fazës së procedurës paraprake nga prokurori nuk ishin bindëse. Dëshmitari B e ka mohuar madje edhe deklaratën e tij dhënë në gjykatën e hapur në lëndën P nr.938/13, dëgjuar para Gjykatës Themelore të Mitrovicës më 14 tetor 2014, në lidhje me rrahjen e tij nga **S. G.** Ai nuk e ka shpjeguar ndryshimin thelbësor në versionin e tij të ngjarjeve në asnjë mënyrë tjetër përveç që thjesht e ka mohuar se kishte thënë diçka të ndryshme.

**R. S.**

153. Trupi gjykues e ka vlerësuar besueshmërinë e dëshmisë që e ka dhënë dëshmitari R. S. dhe ka ardhur në përfundim se dëshmia e tij nuk ishte e besueshme.
154. R. S. e ka mohuar deklaratën e Dëshmitarit A në lidhje me rrethanat e lirimit të tij nga \_\_\_\_\_. Sipas Dëshmitarit A, **R. S.** ishte ushtari, i cili e hapi

---

<sup>48</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 9 dhjetor 2014 f. 13.

<sup>49</sup> Procesverbali i shqyrtimi gjyqësor; 9 dhjetor 2014 f. 9.

qelinë dhe e la Dëshmitarin A të shkonte. Ky mohim nuk ishte bindës, sepse dëshmia e R. S. përmbante elemente të tjera, të cilat duket të ishin joreale dhe nuk përputhen me mendimin praktik, gjë që i bën të gjitha deklaratat e tij jo të besueshme.

155. Sipas rrëfimit të dëshmitarit, ai u takua me Dëshmitarin A vetëm dy herë në jetën e tij.
156. Takimi i parë kishte ndodhur rreth \_\_\_\_\_ para luftës dhe kjo kishte zgjatur për një moment shumë të shkurtër. Të dy burrat u takuan vetëm në rrugë për herë të parë në jetën e tyre, u prezantuan me njëri-tjetrin, dhe folën për disa minuta. Nuk ndodhi asgjë e pazakontë apo e rëndësishme gjatë takimit, që do të justifikonte që ajo të mbahej mend në atë masë që lejon njohjen e bashkëbiseduesit \_\_\_\_\_ më vonë.
157. Me rastin e dytë supozohet se R. S. e kishte parë Dëshmitarin A nga një distancë prej 20 m gjersa R. S. ishte duke e lidhur një plagë të hapur. R. S. paraqiti rrethana mjaft dramatike të atij takimi të dytë; kjo ka ndodhur gjatë bombardimit me artileri, kur shumë refugjatë kishin ikur. Plaga që R. S. e kishte pësuar ishte serioze, por kjo nuk e ndaloi atë që ta vërente dhe ta njihte njeriun që supozohet se e kishte takuar për disa minuta \_\_\_\_\_ më parë, edhe pse atje ishin, siç tha ai, ndoshta 50 apo 100 njerëz. Kujtesa e tij dukej të ishte në mënyrë joreale selektive, pasi që atij nuk iu kujtua asnjë kalimtar tjetër. Përgjigja e R. S. në pyetjen se si e mësoi ai emrin e Dëshmitarit A, ishte dukshëm e paqartë. Ai e kundërshtoi vetveten, duke thënë se ai e dinte emrin dhe pastaj se e mësoi emrin e tij gjatë takimit të parë.

#### **B. V. dhe D. R.**

158. Trupi gjykues besoi se dëshmitari B. V., dëshmitari D. R. dhe B. D. kishin shërbyer në \_\_\_\_\_ në të njëjtën Brigadë të \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_, ë cila ishte stacionuar në një vend të quajtur \_\_\_\_\_ në fshatin \_\_\_\_\_<sup>50</sup>

---

<sup>50</sup> Procesverbali nga shqyrtimi gjyqësor; 12 shkurt 2015. f. 3.

159. Megjithatë, trupi gjykues erdhi në përfundim se faktet e paraqitura nga B. V. dhe D. R. nuk e përjashtonin pjesëmarrjen e B. D. në rrahjen e Dëshmitarit A dhe Dëshmitarit B.
160. As B. V. e as D. R. nuk kanë paraqitur ndonjë fakt të veçantë, që lidhet me të njohurin e tyre B. D., edhe pse ata thanë se ata kishin kaluar disa muaj së bashku. D. R. madje edhe nuk i kujtohej nëse kishte shërbyer me B. D. në të njëjtën togë apo në një togë tjetër. B. V. dhe D. R. i bazuan konkluzionet e tyre, se B. D. nuk kishte mundësi që të ishte i pranishëm në \_\_\_\_\_, vetëm në supozimin e tyre se asnjë ushtar kurrë nuk kishte munguar gjatë thirrjeve që zhvilloheshin në mëngjes.
161. Është një fakt i njohur se largësia në mes fshatit \_\_\_\_\_ dhe fshatit \_\_\_\_\_ është largësi që mund ta bësh në këmbë. Sipas D. D. kjo është në mes \_- \_ km.
162. Duke pasur parasysh numrin e ushtarëve në brigadë, asnjë nga faktet e paraqitura nga B. V. dhe D. R. nuk e ka bindur panelin, që ata do ta vërenin dhe do ta mbanin mend mungesën e B. D. gjatë mbrëmjes dhe gjatës natës. Distanca deri në \_\_\_\_\_ padyshim që ua ka mundësuar të akuzuarit për të arritur deri atje.

#### **I. Xh.**

163. I. Xh. dëshmoi se D. D., i regjistruar si ushtar i \_\_\_\_\_ në brigadën nr. \_\_\_\_\_, u largua nga \_\_\_\_\_ për në \_\_\_\_\_ më \_\_\_\_\_, dhe u kthye vetëm në fund të \_\_\_\_\_ ose fillim të \_\_\_\_\_ në vitin \_\_\_\_\_.
164. I. Xh. shpjegoi se ai ishte në njohuri në lidhje me mungesën e D. D. në \_\_\_\_\_ në kohën që lidhet me akuzat, për shkak se ai iu kishte referuar regjistrit të ushtarëve të brigadës nr. \_\_\_\_\_.
165. Ai ia paraqiti regjistrin trupit gjykues. Doli se kjo ishte një listë e të gjithë pjesëtarëve të brigadës, të dhënat e tyre personale, data kur ata u bashkuan me \_\_\_\_\_ dhe datën e përfundimit të shërbimit të tyre, \_\_\_\_\_ të vitit \_\_\_\_\_. Në asnjë mënyrë nuk tregonte se

**D. D.** ishte në \_\_\_\_\_ në kohën kritike.<sup>51</sup> Pas pyetjeve të parashtruara nga trupi gjykues, I. Xh. shpjegoi se ai e dinte se **D. D.** kishte shkuar në \_\_\_\_\_, për shkak se të afërmit e tij ishin në të njëjtin grup të njerëzve që kishin shkuar atje.

166. Dëshmia e I. Xh. nuk korrespondon me deklaratën e dhënë nga dëshmitari S. M.. S. M. dëshmoi se **D. D.** u kthye në \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_ dhe ka marrë pjesë në luftimet që u zhvilluan në \_\_\_\_\_.

167. I. Xh. nuk kishte njohuri për detajet e qëndrimit të **D. D.** në \_\_\_\_\_. Trupi gjykues arriti në përfundimin se dëshmitari nuk paraqiti fakte, të cilat në fakt do të bindnin trupin gjykues që **D. D.** nuk ka mundur të merrte pjesë në rrahjet në \_\_\_\_\_.

#### **S. M.**

168. S. M. dëshmoi se ai ka qëndruar me **D. D.** në një vend të quajtur \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_ për një kohë gjatë periudhës mes \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_. Në \_\_\_\_\_ ata gjithashtu kishin marrë pjesë në luftime në \_\_\_\_\_, që gjendet në \_\_\_\_\_.

169. Trupi gjykues ka vënë re se dëshmitari e ka ndryshuar versionin e tij të ngjarjeve gjatë marrjes në pyetje dhe për këtë arsye dëshmia e tij është konsideruar si jo bindëse.

170. Fillimisht dëshmitari ka deklaruar se ai ishte larguar nga \_\_\_\_\_ më \_\_\_\_\_. Më vonë, gjatë marrjes në pyetje në mënyrë të tërthorte ai e ka kundërshtuar veten e tij dhe ka thënë se ai ishte larguar nga \_\_\_\_\_ më \_\_\_\_\_ dhe kishte shkuar në \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_ dhe më pas më \_\_\_\_\_ kishte shkuar në \_\_\_\_\_, ndërsa **D. D.** kishte qëndruar në \_\_\_\_\_.

171. Sipas dëshmitarit në \_\_\_\_\_ qëndronin rreth \_\_\_\_\_ persona nga \_\_\_\_\_, por ai e kishte parë **D. D.** çdo mbrëmje, sepse ata jetonin në të njëjtën ndërtesë.

---

<sup>51</sup> Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor; 12 shkurt 2015, f. 13.

172. Data e saktë e rrahjes së Dëshmitarit A dhe Dëshmitarit B, që i atribuohet **D. D.**, nuk është vërtetuar. Dëshmitari A ka thënë se rrahja kishte ndodhur rreth \_\_\_ ditë para se ai të lirohej dhe se ai ishte liruar në mes të \_\_\_ dhe \_\_\_\_\_. Për këtë arsye, rrëfimi i treguar nga **S. M.**, në fakt nuk e përjashton pjesëmarrjen e **D. D.** në rrahje. Sidoqoftë, trupi gjykues e konsideroi rrëfimin të jetë gjithsesi jo bindës.
173. Dëshmitari nuk ka paraqitur ndonjë arsye bindëse, që do të shpjegonte se pse prania e vazhdueshme e **D. D.** në \_\_\_\_\_ ka mbetur në kujtesën e tij pas \_\_\_ vjetësh. Dëshmitari nuk ka treguar ndonjë lidhje të veçantë në mes tij dhe të akuzuarit dhe nuk i kujtohet ndonjë ngjarje që do të nguliste në kujtesën e tij veprimet e **D. D.** në \_\_\_\_\_. Duke pasur parasysh numrin e madh të njerëzve që qëndronin në \_\_\_\_\_, dukej joreale të përjashtohej mundësia që mungesa e **D. D.** nga vendi për një kohë që do të lejonte që ai të shkonte në \_\_\_\_\_, do të mbetej pa u vënë re ose nuk do të mbahej mend nga dëshmitari.

#### **D. Klasifikimi ligjor i veprimeve që i vishen të akuzuarve**

##### **I. Identiteti subjektiv i aktgjykimit mbi aktakuzën**

174. Në bazë të nenit 360 paragrafi 2 i KPPK- së, klasifikimi ligjor i akuzave të paraqitura nga prokurori nuk është detyrues për gjykatën.
175. Për shkak të parimit të identitetit subjektiv të aktgjykimit në lidhje me aktakuzën, veprat penale që iu atribuohen të akuzuarve në aktgjykim nuk mund të përbëheshin nga elemente materiale që nuk ishin të pranishme në përshkrimin e pikave të aktakuzës të paraqitura në aktakuzë. Për këto arsye, trupi gjykues nuk ua atribuon ndonjë lëndim trupor konkret veprimeve, për të cilat ishin dënuar të akuzuarit.

176. Çdo element i veprave penale të kryera nga ana e të akuzuarve, që nuk kanë qenë pjesë e akuzave të paraqitura ndaj tyre në aktakuzë, nuk mund të konsiderohen për qëllimet e klasifikimit ligjor të këtyre veprave.

## **II. E drejta ndërkombëtare humanitare**

177. Veprimet që iu atribuohen të akuzuarve ishin zhvilluar në periudhën e përleshjeve të armatosura mes ushtrisë së rregullt të \_\_\_\_\_ të luftëtarëve që i përkisnin \_\_\_\_\_ të \_\_\_\_\_.

178. Veprimet përbëheshin nga dhuna ndaj personave civilë.

179. Egërsia e luftës ka qenë subjekt i përpjekjeve të bëra nga bashkësia ndërkombëtare për të kufizuar efektet e operacioneve ushtarake, duke mbrojtur personat, të cilët nuk merrnin pjesë në luftime. Përpjekjet kanë kontribuar në zhvillimin e një dege të së drejtës ndërkombëtare e quajtur e drejta ndërkombëtare humanitare. Shkeljet e rënda të këtij ligji janë dënuar si krime lufte.

### **a. Përkufizimi i veprave të ndaluara**

180. Mbrojtja ligjore e civilëve në situata të konfliktit të armatosur jo-ndërkombëtar ka filluar me nenin 3 i përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të miratuara më 12 gusht 1949:

*"Ne rastet e një konflikti të armatosur me karakter jo - ndërkombëtar në një territor në të cilin njëra nga palët në konflikt ka përqendrimin me të madh, të gjitha palët në konflikt janë të detyruara t'i zbatojnë, si minimum, pikat e mëposhtme:*

1. Personat të cilët nuk marrin pjesë aktive në këto ndodhi, duke përfshirë edhe pjesëtarë të forcave të armatosura të cilët kanë ulur armët dhe ata të cilët janë në gjendje të papërshtatshme luftimi për shkak sëmundjesh, plagësh, burgimi, dhe ndonjë shkak tjetër, do të trajtohen në të gjitha rrethanat në mënyrë humane, pa ndonjë dallim për shkak të racës, ngjyrës, fesë ose besimit, gjinisë ose pasurisë ose ndonjë kriteri tjetër të ngjashëm.

Për këtë qëllim, veprimet e mëposhtme janë dhe do të mbeten, në çdo kohë, vend dhe rrethanë lidhur me personat e mësipërm, të ndaluara:

(a) dhunim të jetës dhe personit, në veçanti vrasje të të gjitha llojeve, prerje, keqtrajtim, dhe torturë;

(b) marrje peng e njerëzve;

(c) shfryrje mbi dinjitetin personal dhe në mënyrë të veçantë trajtimin degradues dhe poshtërues

(d) kalimin e procedurës së gjykimit dhe ekzekutimit pa gjykim të mëparshëm i cili nuk është shqiptuar nga një gjykim i rregullt që të ketë përfshirë të gjitha garancitë gjyqësore që konsiderohen si të pazëvendësueshme për personat e civilizuar"

181. Përshkrimi i akteve për tu ndaluar u plotësuan me nenin 4 paragrafi 2 i Protokollit Shtesë II. Ishte rekomanduar dënimi i akteve të mëposhtme:

a) dhuna ndaj jetës, shëndetit dhe mirëqenies fizike ose mendore të personave, veçanërisht vrasjet si dhe trajtimi çnjerëzor, si për shembull tortura, gjymtimi ose çdo formë e dënimit fizik;

b) dënimet kolektive;

c) marrja e pengjeve;

d) akte terrorizmi;

e) shkeljet ndaj dinjitetit personal, veçanërisht trajtimi poshtërues dhe degradues, përdhunimi, prostitucioni i detyruar dhe çdo formë ose sulm i pahijshëm;

f) skllavëria dhe tregtia e skllevërve në të gjitha format e tyre;

g) grabitja;

h) kërcënime për kryerjen e ndonjë prej akteve të mësipërme

182. Republika Popullore Federative e Jugosllavisë i ka ratifikuar Konventat e Gjenevës të gushtit 1949 me Nenin e Përbashkët 3 më 15 shtator 1950<sup>52</sup>. Më 28 dhjetor 1978 është ratifikuar Protokolli Shtesë II i të katër Konventave të Gjenevës nga shteti nën emrin e saj të ri, përkatësisht si Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë<sup>53</sup>.

#### **b. Ekzistenca e konfliktit të armatosur jo-ndërkombëtar**

183. Trupi gjykues ka zbatuar përkufizimin funksional të konfliktit të armatosur jo-ndërkombëtar të dhënë nga jurisprudenca e Gjykatës Ndërkombëtare për Krimet në ish-Jugosllavi (ICTY) në rastin Tadiq<sup>54</sup>. Ky përkufizim është zbatuar zakonisht nga GJNKJ-ja (ICTY) për karakterizimin e konfliktit të armatosur jo-ndërkombëtar<sup>55</sup>:

---

<sup>52</sup> Sluzbeni vjesnik Predizijuma Narodne Skupstine FNRJ broj 6/ 1950. Rujna 1950.

<sup>53</sup> Medunarodni ugovori at 1083 ( Kontratat Ndërkombëtare me 1083)

<sup>54</sup> Prokurori v Tadic, rasti nr.IT-94-1-AR72 Vendimi lidhur me propozimin e mbrojtjes për ankesën bisedore lidhur me juridiksionin , 2 tetor 1995.

<sup>55</sup> Prokurori v.Delalic, Mucic, Delic dhe Landzo, Aktgjykimi i Dhomës së Gjykimit, 16 nëntor 1998, ICTY Rasti nr. IT-96-21-T, par. 183; Prokurori v. Furundzija, Aktgjykimi I Dhomës së Gjykimit, 10 dhjetor 1998, ICTY Rasti nr. IT-95-17/1, par.59; Prokurori v. Kordic dhe Cerkez, Aktgjykimi I Dhomës së Apelit, 17 dhjetor 2004, ICTY Rasti nr. IT-95-14/ 2-T,par.336; Prokurori v. Kunarac, Kovac dhe Vukvic, Aktgjykimi I Dhomës së Gjykimit ,22 shkurt 2001, ICTY Rasti nr.IT-96-23,par. 402; Prokurori v. Kunarac, Kovac dhe Vukvic, Aktgjykimi I Dhomës së Apelit,12 qershor 2002, ICTY Rasti nr.IT-96-23,par. 56; Prokurori v. Nalelitic dhe Martinovic, Aktgjykimi I Dhomës së Gjykimit, 31 mars 2003, ICTY Rasti Nr. IT- 98- 34-T, par.177; Prokurori v. Staki,Rasti nr. IT—97-24-T, Aktgjykimi, Dhoma e Gjykimit II, 31 korrik 2003,par. 568; Prokurri v. Slobodan Milosevic, Vendimi I Dhomës së Tretë lidhur me Mocionin për Aktgjykim Lirues ( Milosevic Rule 98bis Vendimi), ICTY Rasti nr. IT-02-54-T, 16 qershor 2004,par. 16; Prokurori v. Blagojevic dhe Jokic, Rasti nr. IT-02-60-T, Aktgjykimi, Dhoma e Gjykimit I, 17 janar 2005,par. 536; Prokurori v.Strugar, Rasti nr. IT-01- 42- T, Aktgjykimi, Dhoma e Gjykimit II, 31 janar 2005,par. 215; Prokurori v. Limaj, Bala dhe Musliu, Rasti nr. IT-03-66-T,Aktgjykimi,30 nëntor 2005,par.84; Prokurori v. Ori, Aktgjykimi, Rasti Nr. IT-03-68-T, Dhoma e Gjykimit II, 30 qershor 2006, par. 254;



"Konflikti i armatosur ekziston sa herë që ka një drejtim drejt forcës së armatosur midis shteteve ose dhunës së zgjatur të armatosur në mes të autoriteteve qeveritare dhe grupeve të armatosura të organizuara ose ndërmjet grupeve të tilla brenda një shteti".

184. Duhet theksuar se dispozitat e Nenit 3 i Përbashkët për Konventat e Gjenevës duhet të zbatohen edhe jashtë arenës aktuale të veprimeve luftarake, që do të thotë në të gjithë territorin nën kontrollin e një pale, pa marrë parasysh nëse zhvillohen luftime aktuale.

185. Jurisprudenca e GJNKJ-së u referohet dy kritereve themelore të konfliktit të zgjatur të armatosur: organizimit të palëve dhe intensitetit të dhunës.

186. Supozohet se forcat e rregullta apo të kontrolluara nga qeveria i plotësojnë këto kritere. Në lidhje me grupet e armatosura jo-qeveritare, elementet e mëposhtme duket të jenë vendimtare: ekzistenca e një strukture komanduese, autoriteti për të nisur operacione duke bashkuar njësi të ndryshme, aftësia për të rekrutuar dhe trajnuar luftëtarë të rinj ose ekzistencën e rregullave të brendshme.

187. Trupi gjykues i pranoi të gjeturat e GJNKJ- së në rastin Prokurori v Limaj:

*"Para fundit të majit të vitit 1998 UÇK-ja tashmë zotëronte mjaftueshëm karakteristikat e një grupi të armatosur të organizuar, të aftë për t'u angazhuar në një konflikt të brendshëm të armatosur"<sup>56</sup>;*

*"Sulmet e UÇK-së u kryen kundër objektivave të një shumëllojshmërie të ushtrisë serbe, komunitetit dhe objektivave komercial mbi një zonë të gjerë dhe zgjeruar të Kosovës"<sup>57</sup>;*

---

<sup>56</sup> Prokurori v. Limaj, Bala dhe Musliu, Rasti nr. IT-03-66-T, Aktgjykimi, 30 nëntor 2005, par. 134.

<sup>57</sup> Po aty, par. 169.

*"Shumë operacione luftarake u kryen në zonën e Drenicës, ku UÇK-ja ishte e zhvilluar më herët dhe ndoshta ishte e organizuar më së miri.<sup>58</sup>"*

188. Intensiteti i përleshjeve të armatosura në atë kohë kritike është vlerësuar nga paneli duke iu dhënë konsideratë: angazhimit të trupave qeveritare, përdorimit të artilerisë, shkatërrimit të pronës, zhvendosjes së popullatës vendëse, të cilat janë dëshmuar në shqyrtim gjyqësor dhe ekzistimi i viktimave, i cili është një fakt i njohur. Trupi gjykues e ka ndjekur konceptin e zbatuar nga ICTY në Rastin Prokurori v. Milosevic. (Prokurori kundër Slobodan Milosevicit, Lënda Nr. IT-02-54-T, Rregulla 98 bis Vendimi, 16 qershor 2004, para. 26-32)
189. Për këtë arsye, trupi gjykues arriti në përfundimin se, në kohën e veprimeve që iu atribuohen të akuzuarve, në rajonin e Drenicës po zhvillohej një konflikt i armatosur jo-ndërkombëtar në kuptim të Nenit 3 të përbashkët. Ekzistenca e një konflikti të tillë nuk u kundërshtua nga avokati mbrojtës.

### **c. Lidhje**

190. Trupi gjykues e zbatoi konceptin e praktikuar nga GJNKJ-ja në lidhje me domosdoshmërinë e një lidhjeje në mes të veprimit të akuzuarve dhe luftës për të klasifikuar një vepër penale të kryer gjatë konfliktit të armatosur, si krim lufte.

191. GJNKJ -ja në rastin Tadic ka shprehur mendimin se:

*"Duhet të jetë një lidhje e qartë në mes të veprës penale dhe konfliktit të armatosur[. . .] Është e mjaftueshme që krimet e pretenduara të ishin të lidhura ngushtë me armiqësitë që ndodhnin në pjesë të tjera të territoreve*

---

<sup>58</sup> Po aty, par. 170.

*të kontrolluara nga palët në konflikt." (Prokurori kundër Tadic, Lënda Nr. IT-94-1, Vendimi lidhur me Propozimin e Mbrojtjes për ankesën për juridiksionin, 2 tetor 1995, para. 70.)*

192. Në rastin e njëjtë, GJNKJ-ja ka theksuar faktin se një krim lufte mund të ushtrohet edhe në qoftë se "përleshjet thelbësore nuk ishin duke ndodhur në rajon në kohën dhe vendin" ku pretendohet se janë kryer krimet. (Po aty)

193. Një shpjegim më i hollësishëm mbi këtë çështje është prezantuar nga Dhoma e Apelit e GJNKJ-së në rastin Kunarac:

*"Ajo që në fund të fundit e dallon një krim lufte nga një veprë thjesht të brendshme është se një krim lufte është i formuar nga ose varet nga mjedisi - konflikti i armatosur - në të cilin ajo është kryer. Ajo nuk duhet të ketë qenë e planifikuar apo e mbështetur nga ndonjë formë e planit ose linje të veprimit. Konflikti i armatosur nuk është e nevojshme të ketë qenë shkaktar për kryerjen e krimit, por ekzistenca e një konflikti të armatosur duhet, të paktën, të ketë luajtur një rol të rëndësishëm në mundësinë e kryesit për të kryer atë, vendimin e tij për të kryer atë, mënyrën, në të cilën është kryer ose qëllimi për të cilin është kryer. Prandaj, në qoftë se ajo mund të vërtetohet, si në rastin në fjalë, se kryesi ka vepruar në mbështetje të ose nën maskën e konfliktit të armatosur, do të ishte e mjaftueshme për të konkluduar se veprimet e tij ishin të lidhura ngushtë me konfliktin e armatosur.<sup>59</sup>"*

194. Paneli ka vlerësuar se veprimet që kanë ndodhur në \_\_\_\_\_ ishin të lidhura në mënyrë të qartë me konfliktin e armatosur që po zhvillohej:

194.1. Të gjithë autorët ishin pjesëtarë të një grupi të armatosur që ishte i strukturuar mirë dhe që

---

<sup>59</sup> Prokurori v. Kunarac, Kovac dhe Vukvic, Aktgjykimi i Dhomës së Apelit, 12 qershor 2002, par. 58 dhe 59.

kontrollonte në mënyrë efektive të paktën një pjesë të territorit të Kosovës. Kontrolli ka pamundësuar çdo aktivitet të agjencive qeveritare, duke përfshirë zbatimin shtetëror të ligjit, i cili kishte marrë një pozicion të një armiku dhe persekutuesi të popullsisë \_\_\_\_\_. Prandaj, civilët ishin të privuar nga çdo formë e mbrojtjes ligjore kundër akteve arbitrare dhe sulmuese të kryera nga \_\_\_\_\_ e \_\_\_\_\_. Fajtorët kanë gëzuar mosndëshkim të përkohshëm;

194.2. Arrestimi i Dëshmitarit A dhe Dëshmitarit B dhe keqtrajtimi që e kanë vuajtur në \_\_\_\_\_ ishte i mundur, për shkak të mungesës së mbrojtjes ligjore që duhet të sigurohej nga shteti në kohë paqeje. Për një mbrojtje të tillë, normalisht do të kujdesej një sistem i organeve dhe procedurave kompetente për të shqyrtuar ankesat kundër paligjshmërisë dhe kushteve te paraburgimit;

194.3. Përveç kësaj, abuzimi të cilit iu ishte nënshtruar Dëshmitari A, ishte i motivuar nga bashkëpunimi i tij i supozuar me \_\_\_\_\_ \_\_\_\_\_.

#### **d. Pesha e shkeljeve të së drejtës humanitare ndërkombëtare**

195. Formulimi i nenit 3 të përbashkët dhe Protokollit Shtesë II nuk ka ngritur ndonjë prag të peshës së shkeljes së dispozitave, që përcaktojnë këto akte kundër civilëve, që duhet të ndalohen gjatë konflikteve të armatosura jo-ndërkombëtare. Dispozitat i obligojnë shtetet, që të dënojnë shkeljet nëpërmjet legjislacionit të brendshëm.

196. Ishte vetëm në vitin 1977, me rastin e miratimit të Protokollit Shtesë të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e viktimave të konflikteve të armatosura ndërkombëtare (Protokollit Shtesë I), që bashkësia ndërkombëtare ka rënë dakord për ta pranuar një klauzolë të qartë sipas së cilës "shkeljet e

rënda të instrumenteve të së drejtës ndërkombëtare humanitare, do të konsiderohen si krime lufte.<sup>60</sup>

197. Të gjitha pjesët e legjislacionit të brendshëm që kanë të bëjnë me krimet e kryera kundër civilëve, nuk kanë ofruar ndonjë prag të seriozitetit apo peshës për shkelje konkrete të ligjit ndërkombëtar humanitar. Kodi Penal i Kosovës (KPK) [ Kodi ka hyrë në fuqi më 6 prill 2004 me emrin Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK). Sipas Ligjit Nr. 03/L-002 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 6 nëntor 2008, kodi ka mbetur si Kodi Penal i Kosovës (KPK)] në nenin e tij 120 paragrafi 2 dhe Kodit Penal i Republikës së Kosovës ( KPRK) në nenin e tij 152 paragrafi 2 përcakton se çdo shkelje e dispozitave të nenit 3 të përbashkët, përbën shkelje të rëndë, pa iu referuar rrethanave të veçanta të një krimi konkret.

198. Koncepti "krime lufte" i pranuar bashkërisht nga bashkësia ndërkombëtare, d.m.th. krimet e kryera gjatë konfliktit të armatosur, që kërkojnë dënimin penal të fajtorit, u referohet shkeljeve serioze të ligjeve ose zakoneve të konflikteve të armatosura ndërkombëtare ose të brendshme<sup>61+62</sup>.

199. Jurisprudenca e GJNKJ-së e ka themeluar interpretimin e mëposhtëm: shkelja e së drejtës ndërkombëtare humanitare është serioze, në qoftë se ajo përbën shkelje të një "rregulli për mbrojtjen e vlerave të rëndësishme, dhe shkelja duhet të përfshijë pasoja të rënda për viktimën"<sup>63</sup>.

---

<sup>60</sup> Protokollin Shtesë i Konventave të Gjenevës i 12 gushtit 1949, dhe qe që kanë të bëjnë me mbrojtjen e viktimave të konflikteve të armatosura ndërkombëtare (Protokollin Shtesë I) 1125 UNTS 3, 8 qershor 1977, hyri në fuqi më 7 dhjetor 1979, neni 85 (5).

<sup>61</sup> Shih Nenin 8 të Statutit të ICC, Neni 2 I Statutit të ICTY, Neni 4 I Statutit të ICTR, neni 3 I Statutit të SCSL dhe 6. 1 I Rregullores 2000/15 lidhur me Themelimin e Paneleve me kompetenca ekskluzive lidhur me veprat e rënda penale (në Timorin Lindor), Dok. Nr. UNTAET/REG/2000/15 I 6 qershorit 2000.

<sup>62</sup> Të vjedhësh një copë bukë në një territor të okupuar nuk e nxjerr kriminelin e luftës nga forca okupuese": në Tadic (Vendimi lidhur me mocionin e mbrojtjes për ankesën bisedore lidhur me juridiksionin ), 2 tetor 1995, Rasti nr. IT-94-1-AR/ 72 (ICTY Dhoma e Apelit), par. 94.

<sup>63</sup> Kunarac, Kovac dhe Vokovic, 12 qershor, 2002, par. 66.

200. Paneli pranoi plotësisht këtë interpretim dhe arriti në përfundimin se rrahjet e përsëritura ndaj Dëshmitarit A dhe se incidenti kur Dëshmitari A dhe Dëshmitari B u rrahën në të njëjtën kohë, përbën shkelje serioze të ligjit ndërkombëtar humanitar.
201. Shkalla e shkeljes së integritetit trupor dhe dinjitetit e ka arritur pragun e kërkuar për krime lufte. Përveç kësaj, ai ishte kërcënuar me vdekje dhe ishte poshtëruar me akuzat e të qenurit spiun. Ky abuzim zgjati për një periudhë të zgjatur kohe.
202. I njëjti klasifikim iu dha rrahjeve të personave në fjalë në të njëjtën kohë. Trupi gjykues ka gjetur detyrimin që ata të rrihnin njëri-tjetrin si paturpësisht poshtërues dhe degradues.
203. Shkalla e poshtërimit dhe shkeljes së integritetit trupor të të dy viktimave ishte e lartë. Ata ende i vuajnë pasojat e rënda të \_\_\_\_\_, pasi që ata duhet të vihen nën mbrojtje në mënyrë që të dëshmojnë në gjykatë për ngjarjet që ndodhën atje dhe ata ende kanë shqetësime serioze për sigurinë e tyre personale.

#### **e. Zbatimi i ligjit vendor**

204. E drejta humanitare ndërkombëtare nuk parasheh sanksione ndaj veprave të ndaluara me këtë ligj dhe rekomandon se ato duhet të jenë të dënueshme nga legjislativi vendor. Vepra e kryer nga i akuzuari përbëhet prej elementeve të shkeljes së rëndë të së drejtës humanitare ndërkombëtare e cila është dashur të klasifikohet me zbatimin e legjislativit vendor.

205. Klasifikimi ligjor i akteve të cilat i janë atribuar secilit nga të akuzuarit ka rezultuar nga krahasimi i kryerjes së veprave të tyre me elemente të caktuar kriminale të parapara me dokumente të ndryshme të legjislacionit vendor.
206. Trupi gjykses ka marrë parasysh ndryshimin e së drejtës materiale e cila ka ndodhur pas kohës kur janë kryer veprat gjegjëse dhe para kohës kur është shqiptuar dënimi. Trupi gjykses ka krahasuar hollësisht dispozitat ligjore sipas ligjit në fuqi lidhur me kohen e kryerjes së veprës me të cilën ngarkohet i akuzuari.

#### **i. Parimi i ligjshmërisë**

207. Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka hyrë na fuqi me 15 qershor 2008 ka adoptuar parimin e ligjshmërisë i cili në shtetet e civilizuar konsiderohet si rregull themelore e drejtësisë penale. Ajo parasheh se askush nuk duhet dënuar për ndonjë vepër apo lëshim i cili nuk ka përberë vepër penale sipas ligjit në fuqi ne kohen e kryerjes.
208. Në të njëjtën kohë Kushtetuta e njuh përjashtimin thelbësor ne këtë parim. Përjashtimi mundëson dënimin e kryerësve të veprave penale në kohen kur i kane kryer që përbën gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit sipas të drejtës ndërkombëtare. Parimi i ligjshmërisë dhe përjashtimi i parimit të jo - retroaktivitetit të së drejtës penale materiale janë të parapara me nenin 33 paragrafi 1 i Kushtetutës:

*"Askush nuk mund të akuzohet ose të dënohet për asnjë vepër e cila, në momentin e kryerjes, nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si vepër penale, me përjashtim të veprave të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, sipas së drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit."*

209. Ky përjashtim nga ky parim i ligjshmërisë na pajtim me nenin 7 paragrafët 1 dhe 2 të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut:<sup>64</sup>

*"1. Askush nuk mund të dënohet për një akt ose një mosveprim që, në momentin kur është kryer, nuk përbënte vepër penale sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale.*

*2. Ky nen nuk do të ndikojë mbi gjykimin dhe dënimin e një personi për një akt ose mosveprim, i cili, në momentin kur është kryer, quhej vepër penale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohura nga kombet e qytetëruara."*

210. Sipas përjashtimit të parimit të jo-retroaktivitetit të së drejtës penale materiale e paraparë me nenin 33 paragrafi 1 i Kushtetutës, jo vetëm LP i RSFJ-së i cili ishte në fuqi në kohën e kryerjes por gjithashtu edhe dokumente përcjellëse të legjislacionit d.m.th. që të dy kodet KPK dhe KPRK mund të konsiderohen për klasifikimin ligjor të krimeve relevante.

#### **ii. Zbatimi i ligjit më të favorshëm**

211. Ka pasur një parim themeltar të qëndrueshëm lidhur me hyrjen në fuqi të detyrueshme të së drejtës më të favorshme materiale në periudhën prej kryerjes së veprave e deri te dënimi.

212. Sipas nenit 4 të KP të RSFJ:

---

<sup>64</sup> Sipas nenit 22 paragraf 2 të Kushtetutës së Kosovës dispozitat e Konventës Evropiane për mbrojtje e të drejtave themelore të lirive të njeriut janë inkorporuar direkt në Republikën e Kosovës, dhe në rast kundërtënie, ka përparësi mbi dispozitat e ligjeve dhe akteve tjera të institucioneve publike.



*"1. Ligji i cili ka qenë në fuqi në kohën kryerjes së veprës penale do të aplikohet ndaj personit i cili ka kryer veprën penale.*

*2. Nëse ligji është ndryshuar një herë ose më shumë pas kryerjes së veprës penale, në atë rast do të aplikohet ligji i cili është me i favorshëm në raport me kryesin."*

213. Parimi i njëjtë është përsëritur në legjislacionin vijues p.sh. në nenin 2 paragrafët 1 dhe 1 të KPK dhe neni 3 paragrafët 1 dhe 2 të KPRK.

214. Ligji nuk përcakton ndonjë që tregon se cili ligj është me i favorshëm. Trupi gjykues e ndoqi interpretimin i cili dikton marrjen parasysh të situatës konkrete të të akuzuarit. Kjo ka bërë të domosdoshëm një simulim të dënimit në pajtim me të dyja dokumentet e legjislacionit gjegjes.

### **iii. Mbrojtja e personave civil gjatë konfliktit të armatosur sipas ligjit vendor**

215. Mbrojtja e personave civil gjatë një konflikti të brendshëm të armatosur me ligjin e vendit i cili ishte në fuqi nga koha e luftës në Kosovë e deri te koha e dënimit në këtë lëndë i është nënshtruar një evolucioni të dukshëm.

216. Së pari neni 142 i LPRSFJ, në formulimin e tij ashtu siç ishte shpallur me 1 korrik 1977, dënonte si krime lufte vetëm ato vepra penale të cilat kishin për cak popullatën civile. Veprat "e dëmshme shoqërore" të orientuara drejt personave civil ishin të dënueshme si krime ordinere

217. Ndryshimi i nenit 142 i LPRSFJ i cili hyn në fuqi më 30 gusht 1990 e zgjeron fushën e dënimeve me natyrë të

veprave penale kundrejt popullatës civile. Përveç një numri të caktuar të veprave penale kundrejt popullatës civile me këtë ndryshim dënoheshim si krime edhe veprat penale kundër personave civil apo atyre të paaftë për të luftuar, dhe për shkak kanë vdekjen, lëndime të renda trupore ose dëmtim serioz i shëndetit të njerëzve.<sup>65</sup>

218. Si rregull i përgjithshëm publikuar me Rregulloren e 12 dhjetorit 1999.<sup>66</sup> e nxjerrë nga UNMIK-u, dhe që kishte efekt retroaktiv nga data 10 qershor 1999, ligji i cili hyri në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989 dhe para 10 qershorit 1999 nuk ishte i zbatueshëm. Sidoqoftë, krimet e luftës kundër personave civil nuk ishin më çështje e dispozitave kalimtare. Prandaj, sipas paragrafit 1.2 të kësaj Rregulloreje, gjykata mundet përjashtimisht t'i zbatojë dispozitat relevante të cilat ishin shpallur pas 22 marsit 1989, për aq kohë sa nuk janë diskriminuese dhe në përputhje me nenin 1.3 të Rregullores së njëjtë.
219. Sidoqoftë, madje edhe neni i ndryshuar 142 në përmbajtjen e tij të publikuar me datën 30 gusht 1990 nuk i kishte ndëshkuar veprat e kryera ndaj Dëshmitarit A dhe B nga i akuzuari. Si pasojë e këtij parimi të identitetit subjektiv të aktgjykimit në lidhje me aktakuzën është ardhur në përfundim se nga këto vepra nuk ishte shkaktuar lëndim i rëndë trupor apo dëmtim serioz shëndetit.
220. Inkriminimi i veprave të lartpërmendura ishte paraparë me rendin ligjor vendor të Kosovës, gjegjësisht me nenin 120 të KPK. Siç iu referuam më lart, kodi ka hyrë në fuqi më 06 prill 2004 me emrin Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK). Sipas ligjit nr. 03/L-002 me plotësim dhe ndryshimin e KPPK të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me 6 nëntor 2008, kodi ishte riemërtuar si Kod Penal i Kosovës (KPK) megjithatë pa ndonjë ndryshim në formulimin e nenit 120. Personat e mbrojtur janë përkufizuar jo vetëm si civilë por edhe si persona që nuk marrin pjesë në luftime.

---

<sup>65</sup> Gazeta zyrtare e RSFJ 38/90.

<sup>66</sup> 14 UNMIK/REG/1999/24 12 dhjetor 1999.

221. Me nenin 120 paragrafi 1 i KPK parashihet, si vijon:

*"Kushdo që shkel rëndë nenin 3, që është i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949 dënohet me së paku pesë vjet burgim ose me burgim afatgjatë."*

222. Neni 120 paragrafi 2 i kodit precizon se:

*"Shkelje e rëndë e nenit 3, i përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të 12 Gushtit 1949, do të thotë një ose më shumë nga veprat e mëposhtme të kryera në kontekstin e një konflikti të armatosur jo të një karakteri ndërkombëtar kundër personave që nuk marrin pjesë aktive në luftime, duke përfshirë edhe pjesëtarët e forcave të armatosura që i kanë dorëzuar armët dhe që nuk janë në gjendje të luftojnë për shkak të sëmundjes, plagëve, ndalimit ose për ndonjë shkak tjetër:*

*1) Dhuna ndaj jetës dhe personit, në veçanti vrasja e çdo lloji, gjymtimi, trajtimi mizor dhe tortura;*

*2) Kryerja e akteve fyese ndaj dinjitetit të personit, në veçanti poshtërimi dhe trajtimi degradues;*

*3) Marrja e pengjeve;"*

223. Kodi penal i Republikës së Kosovës i cili e ka zëvendësuar KPK ka përsëritur fjalë për fjalë përkufizimin e veprës penale që jepet në Nenin 120 të KPK. Ai ka dhënë përkufizimin e personave të mbrojtur por ka zgjeruar katalogun e veprimeve të ndaluara. Sipas nenit 152 të KPRK:

*"1. Kushdo që shkel rëndë nenin 3, që është i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës të*

*datës 12 gusht 1949, dënohet me burgim së paku pesë (5) vjet ose me burgim të përjetshëm.*

2. Shkelje e rëndë e nenit 3, të përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të 12 Gushtit 1949, do të thotë një ose më shumë nga veprat e mëposhtme të kryera në kontekstin e një konflikti të armatosur jo të një karakteri ndërkombëtar kundër personave që nuk marrin pjesë aktive në armiqësi, duke përfshirë edhe pjesëtarët e forcave të armatosura që i kanë dorëzuar armët dhe që nuk janë në gjendje të luftojnë për shkak të sëmundjes, plagëve, ndalimit ose për ndonjë shkak tjetër:

2.1. dhuna ndaj jetës dhe personit, në veçanti vrasja e çdo lloji, gjymtimi, trajtimi mizor dhe tortura;

2.2. kryerja e akteve fyese ndaj dinjitetit të personit, në veçanti poshtërimi dhe trajtimi nënçmues;

2.3. marrja e pengjeve;

2.4. shqiptimi i dënimeve dhe kryerja e ekzekutimeve pa aktgjykime paraprake të shpallura nga një gjykatë e rregullt që ofron të gjitha garancitë gjyqësore të cilat përgjithësisht njihen si të domosdoshme."

224. Trupi gjykues ka vlerësuar se veprat e kryera nga të akuzuarit në lidhje me Dëshmitarin A dhe Dëshmitarin B plotësisht korrespondojnë me karakteristikat e krimit sipas nenit 120 paragraf 2 nën paragraf 1 dhe 2 të KPK, dhe njëherësh me nenin 152 paragraf 2 nën paragraf 2.2 të KPRK.

225. Prandaj, duhet analizuar faktet lidhur me lëndën bazuar në të dy legjislacionet për të përcaktuar se çfarë lloji dhe sa krime janë kryer dhe të vlerësohet legjislacioni më i favorshëm.

#### **iv. Bashkëkryerja**

226. Në të gjitha rastet kur rrahjet e përsëritura të Dëshmitarit A dhe gjatë incidentit kur Dëshmitari A dhe Dëshmitari B ishin rrahur mes veti në të njëjtën kohë kishte pasur disa fajtorë të tjerë të cilët po vepronin njëkohësisht. Aktet e tyre janë në pajtim me përkufizimet

e bashkëkryerjes në pajtim me nenin 23 të KPK. I njëjti përkufizim ishte përsëritur edhe me nenin 31 të KPRK:

*"Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thellësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale."*

227. Secili nga të pandehurit ka përmbushur elementet *actus reus* kritere këto sipas të cilave vepra penale përbëhet prej shkeljes se nenit 3 me pjesëmarrje aktive në rrahje. Dhe secili akt individual i ndërmarrë nga persona të caktuar ishte kryer në praninë e kryerësve të tjerë. Secili kryerës e ka shfrytëzuar rastin si rezultat i akteve të kryera nga tjetri pasi viktimës ia kanë pamundësuar vullnetin për të rezistuar. Secili akt individual i kryer nga njëri prej fajtorëve ia ka mbushur mendjen tjetrit ta kryej të njëjtin akt.

228. Në këtë kontest kryerësit të cilët nuk e kanë kërcënuar Dëshmitarin A dhe nuk e kanë akuzuar këtë të fundit për \_\_\_\_\_ në fakt kanë përfituar nga ata të cilët e kanë bërë këtë. Do të thotë se ata iu kanë bashkëngjitur kryerësve kërcënuese *cum animo socii* çka do të thotë se ata i kanë përkrahur në mënyrë të dukshme.

229. Koncepti i njëjtë është zbatuar me rastin e dhënies së urdhrave tek viktimat ashtu që këta të fundit të rraheshin në mes veti, megjithëse vetëm **I. Th.** e kishte dhënë këtë urdhër. Të gjithë kryerësit me praninë e tyre dhe me goditjet e shkaktuara tek viktimat kanë shprehur miratimin dhe mbështetjen e tyre për veprimet.

230. Kjo mbështetje kishte kaluar masën e dhënies së vetëm të një ndihme dhe mbështetje të thjesht pasi që ata kishin shprehur vullnetin tyre që të mbështesnin kryerësit e tjerë duke marrë pjesë në rrahje.

231. Të gjithë të akuzuarit ishin të vetëdijsëm për pjesëmarrjen e të tjerëve sepse ata përveç se i kanë parë ata në vendin e ngjarjes ata edhe kishin kryer veprat e tyre penale. Aktiviteti i tyre ka dëshmuar se ata me dije dhe me dashje kanë kryer këto vepra bashkërisht. Prandaj, veprimet e tyre janë klasifikuar si të kryera në bashkëkryerje.

#### **v. Bashkimi i akteve kriminale**

232. Për shkak të modus operandi identik dhe rastit të njëjtë të shfrytëzuar secilën herë nga kryerësit, trupi gjykues vjen në përfundim se **J. D., Z. D., S. S.,** dhe **I. Th.** kanë pasur qëllim të njëjtë në përgjithësi keqtrajtimit dhe poshtërimin e Dëshmitarit A.

233. Përfundim i njëjtë arrihet edhe në lidhje me veprimet e kryera nga të gjithë të akuzuarit ndaj Dëshmitarit A dhe B në të njëjtën kohë.

234. Nëse i marrim rastet veç e veç, secila nga rrahjet dhe poshtërimet ndaj Dëshmitarit A e që ka ndodhur në dhomën ku ishte mbajtur ai mund të cilësohet si një vepër e vetme penale.

235. Rrahja dhe poshtërimi i Dëshmitarëve A dhe B që kishte ndodhur në të njëjtën kohë në një dhomë më të madhe duhet të konsiderohet si veprim kriminal pikërisht për kohën e njëjtë, dhe identitetin fizik dhe kohezionin veprimeve të kryerësve.

#### **Analiza veprave penale në bashkim sipas KPK-së**

236. KPK nuk përcakton rregullat e klasifikimit të akteve kriminale në bashkim edhe nëse ato janë kryer me të njëjtin qëllim.
237. Trupi gjykues ka aplikuar qasje teleologjike dhe ka konsideruar elementin me qëllimin e njëjtë i cili ka qenë vendimtar për klasifikimin e të gjitha veprimeve ndaj Dëshmitarit A të ndodhura në dhomën ku ishte mbajtur si një vepër penale, nëse klasifikohet sipas atij kodi.
238. Veprimi i përbërë nga rrahjet e njëkohshme të Dëshmitarit A dhe Dëshmitarit B është konsideruar si veprim i ndarë kriminal sepse përmbajta e atij veprimi kriminal dallonte nga rrahjet e Dëshmitarit A kur ka qenë vetëm. Ndryshimi mbështetet në numrin e viktimave dhe në modus operandi: elementi i cenimit të dinjitetit njerëzor ka dominuar në këtë rast.

#### **Analiza e veprave penale në bashkim sipas KPRK-së**

239. KPRK ka paraparë konceptin e krimit për veprat penale në vazhdim. Sipas nenit 81 të KPRK:

*"1. Vepra penale në vazhdim përbëhet nga disa vepra të njëjta ose të ngjashme të kryera në lidhshmëri kohore nga i njëjti kryes, dhe të cilat paraqesin tërësi për shkak të ekzistimit të së paku dy prej kushteve në vijim:*

*1.1. viktimës së njëjtë të veprës penale;*

*1.2. objekti i njëjtë i veprës;*

*1.3. shfrytëzimi i situatës apo marrëdhënies së njëjtë kohore;*

*1.4. vendi apo hapësira e njëjtë e kryerjes së veprës penale; dhe*

*1.5. dashja e njëjtë e kryesit."*

240. Veprimet e kryera nga **J. D., Z. D., S. S.,** dhe **I. Th.** kundrejt Dëshmitarit A duhet të klasifikohen si vepër penale në vazhdim sepse veprimet e lartpërmendura përmbushin të gjitha kushtet si më lart.
241. Rrahjet e njëkohshme në mes Dëshmitarit A dhe Dëshmitarit B nuk janë përfshirë në klasifikimin e veprës penale në vazhdim për shkak të arsyeve të njëjta ngase ato ishin klasifikuar si vepra të ndara penale sipas neneve të KPK, sepse së pari për shkak të rregullit të paraparë me nenin 81 paragrafi 2 i KPRK-së:

*"Veprat penale të kryera kundër personit mund të konsiderohen si vepër penale në vazhdim vetëm nëse janë kryer kundër të njëjtit person."*

242. Trupi gjykues sipas detyrës zyrtare e di se në një tjetër rast **S. S.** ishte burgosur për krime të kryera kundër Dëshmitarit A në bashkëkryerje me persona të tjerë në \_\_\_\_\_ në mënyrë të njëjtë dhe në lidhshmëri kohore me rastin e kësaj lëndë. Neni 81 paragrafi 6 i KPRK mundëson gjykim të ndarë lidhur me një vepër penale e cila nuk është përfshirë në veprën penale në vazhdim.

**Përcaktimi i ligjit më të favorshëm**

243. Dënimi sipas nenit 120 paragrafi 1 i KPK parasheh së paku pesë deri njëzet vjet burgim afatgjatë.
244. Sipas nenit 37 paragrafët 1 dhe 2 të KPK dënimi me burgim afatgjatë mund tu caktohet shumicës së veprave penale të kryera me dashje ose nën rrethana të tejet rënduese ose që shkaktojnë pasoja tejet të rënda. Ky dënim mund të zgjatë për një periudhe kohore prej 21 deri 40 vjet.



245. Sipas nenit 44 paragrafi 1 i KPRK dënimi me burgim afatgjatë mund të caktohet për veprat më të rënda penale të kryera me dashje ose nën një rrethanë të caktuar rënduese. Ky dënim mund të zgjasë nga 21 vite deri në 40 vite.
246. Trupi gjykues ka përfunduar se rrethanat e këtij rasti nuk arsyetojnë caktimin ose të burgimit të afatgjatë ose të përjetshëm për të akuzuarin ngase vepra penale të cilën e kanë kryer nuk mund të konsiderohet si vepër e rëndë penale, e as nuk ka shkaktuar pasoja mjaft të rënda.
247. Sipas të dy kodeve veprimet e kryera nga **J. D., Z. D., S. S. dhe I. Th.** Ishin klasifikuar si dy krime të ndara në bashkim të vërtetë. Rregullat e caktimit të një dënimi unik sipas këtyre dy kodeve janë të njëjta.
248. Për shkak të objekteve dënimet të cilat mund të merreshin në konsideratë nga trupi gjykues ishin *in concreto* dhe dënimi konkret i shqiptuar sipas KPK do të ishte më i lartë: përkatësisht pesë deri në njëzetë vjet burgim sipas KPK, ose burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim sipas KPRK. Prandaj KPRK është marrë si ligj më i favorshëm pasi përshkruan dënim më të butë.
249. Maksimumi i dënimit me burg prej 15 vite qëndron në pajtim me parimet e parapara me nenin 23 paragrafi 2 i Kushtetutës:

*"Asnjë dënim për vepra penale nuk do të tejkalojë sanksionimin e paraparë me ligj në kohën e kryerjes së atij akti kriminal."*

250. Trupi gjykues ka vënë re se fraza 'dënimi me ligj' mund t'i referohet vetëm llojit të dënimeve dhe jo dënimit të caktuar që parashihet me ligj në kohën e kryerjes. Sipas rregullit të nenit 33 paragrafi 1 disa krime lufte duhet dënuar edhe nëse ato nuk janë të dënueshme në kohën e kryerjes së atyre veprave penale dhe në atë kohë nuk është paraparë dënimi për to.

#### **E. Përcaktimi i dënimeve**

251. Gjatë caktimit të dënimeve për të akuzuarit trupi gjykues i kujton qëllimet e dhëna me nenin 41 të KPRK. Përparësi i është dhënë nevojave për të shprehur gjykimin e shoqërisë për veprat penale, ngjitjes së moralit dhe forcimit të obligimit për respektimin e ligjit. Trupi gjykues gjithashtu niset nga parimi i parandalimit të përgjithshëm duke përkujtuar se aktgjykimi është në funksion të parandalimit që njerëzit tjerë të mos kryejnë vepra penale.

252. Trupi gjykues e ka kryer obligimin e vet në vlerësimin e të gjitha faktorëve lehtësues dhe rëndues, siç parashihen me nenin 73 paragrafi 1 i KPRK

#### **I. Faktorët rëndues**

253. Si rrethana rënduese lidhur me veprën penale të kryer nga **S. S., J. D., Z. D. dhe I. Th.** kundrejt Dëshmitarit A, trupi gjykues ka marrë parasysh faktin se ata kishin vazhduar me veprimet e tyre kriminale për një kohë të gjatë dhe me këmbëngulësinë e tyre.

254. Lidhur me veprën penale të kryer njëkohësisht kundrejt Dëshmitarit A dhe Dëshmitarit B trupi gjykues përkujton se poshtërimi i të dy viktimave ishte fyes dhe duke i urdhëruar të rraheshin ndërmjet veti kryerësit po i shtynin drejt braktisjes së dinjitetit njerëzor.

## II. Faktorët lehtësues

255. Si faktor lehtësues trupi gjykues ka pasur parasysh se gjatë zhvillimit të luftës në Kosovë të gjitha të akuzuarit kishin luftuar për kombin e tyre kundrejt një regjimi i cili ishte cilësuar nga bashkësia ndërkombëtare si kriminal dhe për këtë arsye ishte dënuar.
256. Lidhur me të gjithë të akuzuarit trupi gjykues ka marrë parasysh deklaratat se pas lufte ata jetonin jetën në mënyrë të ndershme.
257. **S. S., F. D.** dhe **N. D.** i kanë shërbyer popullatës duke mbajtur pozita politike me rendësi. **I. Th.** gjithashtu ka kryer punë të natyrës prestigjioze.

## III. Lehtësimi i dënimit

258. Trupi gjykues mori parasysh se veprat penale që u ngarkohen **A. D., D. D., B. D., S. D., F. D.,** dhe **N. D.** ishin të ndërlydhura me vetëm një incident. Asnjëri prej tyre nuk ka qenë iniciator i veprës penale. Me asgjë nuk është treguar se ata në fakt e kanë ditur se i kanë kontribuar vuajtjes ë nga Dëshmitari A për shkak të rrahjeve të mëhershme. Prandaj trupi gjykues ka vlerësuar se shkalla e tyre e insistimit për të vazhduar me dashjen kriminale dhe urrejtjen e tyre ka qenë e nivelit mesatar.
259. Ky vlerësim është konsideruar nga trupi gjykues si rrethanë e veçantë lehtësuese e cila tregon se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit më të butë.

260. Prandaj trupi gjykues ka shqiptuar dënime nën kufirin e paraparë me ligj ndaj **A. D., D. D., B. D., S. D., F. D.,** dhe **N. D.** siç edhe lejohet me nenin 75 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe neni 76 paragrafi 1 dhe nën paragrafi 1.2 i KPRK.

#### **IV. Dënimi unik**

261. Gjatë llogaritjes të dënimit të unifikuar ndaj **J. D., S. S.,** dhe **I. Th.,** trupi gjykues kishte marrë parasysh dënimet individuale të caktuara për secilin nga veprat e kryera penale.

262. Këto vepra penale ishin lidhur ngushtë me njera tjetrën me elementet vijuese: vendi i njëjtë, periudha e njëjtë, mundësia e njëjtë. Kjo ka diktuar aspiratë më të moderuar të dënimeve që është term që përdoret rëndom për unifikim apo grumbullim të dënimit.

#### **F. Shpenzimet**

263. Trupi gjykues e ka bazuar vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës penale në dispozitat ligjore të cituara në dispozitiv.

264. Shkalla dhe përpjesëtimi mes shumave të planifikuara që të akuzuarit obligohen t'i kompenzojnë dhe shpenzimeve të përgjithshme të procedurës është caktuar duke marrë parasysh peshën e akuzave kundër tyre dhe numrin e veprimeve hetimore dhe të provave që janë ndërmarrë për t'i vërtetuar akuzat, si dhe shpenzimet lidhur me mendimin e ekspertit mbi gjendjen e tyre shëndetësore.

265. Është e ditur sipas detyrës zyrtare që shpenzimet për mendimin e përgatitur të ekspertit lidhur me gjendjen shëndetësore të **S. S.** janë paguar si shpenzim nga një tjetër lëndë.

---

**Dariusz Sielicki**

**Kryetar i trupit gjykues**

**i EULEX-it**

---

**Agron Kelmendi**

**Procesmbajtës**

**Personat e autorizuar mund të paraqesin ankesë kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën e Apelit përmes Gjykatës Themelore të Mitrovicës brenda afatit prej 15 ditësh pas dorëzimit të një kopje të aktgjykimit sipas nenit 380 paragrafit (1) të KPP-së.**